PARTNERËTSHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

# Matrica e Monitorimit
## mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

# RAPORTI
# PËR SHQIPËRINË 2015

Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER

SWEDEN

BALKAN CIVIL SOCIETY DEVELOPMENT NETWORK

# Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike

## Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve

# Matrica e Monitorimit

## mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

# RAPORTI PËR SHQIPËRINË 2015

Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian

"Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, dhe Olof Palme International Center në Shqipëri nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian, Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze."

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit"Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve" dhe "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave"

**Partner kryesor:**

**Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)**
Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2
1000-Shkup
Maqedoni
Tel.: + 389 (0)2 614 42 11
E-mail: **executiveoffice@balkancsd.net**
Website: **www.balkancsd.net**

**Partner zbatues në Shqipëri:**

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**
Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel.: +355 4 2254881 Fax: +355 4 2254883
Email: **partners@partnersalbania.org**
**http://www.partnersalbania.org**

Botuar në Shqipëri, në Shkurt 2016

**Drejtuese**
Juliana Hoxha

**Grupi i Vëzhgimit**
Kostandina Keruti
Adela Bani
Maris Selamaj
Erila Haska

**Grupi i Administrimit të të Dhënave**
Elona Kapexhiu
Erila Haska

**Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit**
Juliana Hoxha
Klotilda Tavani Kosta
Kostandina Keruti

**Dizajni grafik:** Arben Hamzallari

**Printimi:** SHTËPIA BOTUESE mediaprint

# Përmbajtja

**I. Përmbledhje Ekzekutive ... 6**
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri ... 6
Gjetjet Kryesore ... 7
Rekomandimet Kryesore Politike ... 8
Rreth Projektit dhe Matricës ... 10

**II. Hyrje ... 11**
Rreth Raportit të Monitorimit ... 11
Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile ... 11
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZHSHC) në Shqipëri ... 12
Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri ... 14
Mirënjohje dhe Falënderime ... 14

**III. Metodologjia ... 15**
Përmbledhje e përqasjes metodologjike ... 15
Pjesëmarrja e komunitetit të OSHCve ... 17

**IV. Gjetje dhe Rekomandime ... 18**
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive ... 18
Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit ... 18
Nën-Fusha 1.2. Liritë e tjera ... 22
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHCtë ... 23
Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OSHCtë dhe donatorët e tyre ... 23
Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit ... 28
Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore ... 31
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC ... 34
Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim ... 34
Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikëbërjës dhe vendimmarrjes ... 36
Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve ... 40

**V. Burime të Përdorura dhe Lidhje të Dobishme ... 42**
**VI. Shtojca ... 45**

# I. Përmbledhje Ekzekutive

## Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri

Kuadri ligjor dhe rregullator mbi **garancitë themelore juridike të lirive** për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) është në përgjithësi i harmonizuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai garanton të drejtat e individëve dhe subjekteve për të themeluar, regjistruar, bashkuar dhe për të marrë pjesë lirisht pa diskriminim në organizime formale dhe/ose jo formale, online dhe offline. OSHCtë gëzojnë të drejtën e organizimit dhe/apo pjesëmarrjes në tubime paqësore dhe të drejtën e lirisë së shprehjes.

Kuadri rregullator mbi regjistrimin e OSHCve ende paraqet disa çështje problematike. Centralizimi i procesit të regjistrimit/ri-regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë paraqet vështirësi për individët dhe entitetet që dëshirojnë të regjistrojnë apo ri-regjistrojnë një organizatë për shkak të kostove të larta të regjistrimit, procedurave të gjata dhe mungesës së juristëve, avokatëve dhe gjyqtarëve të specializuar në çështjet ligjore të OSHCve.

Një zhvillim pozitiv përsa i përket rregullave të kontabilitetit dhe raportimit financiar, sjell miratimi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse nga Ministria e Financës gjatë vitit 2015. Standardi përcakton specifikime mbi pasqyrat financiare dhe formatet raportuese të OSHCve, duke marrë parasysh natyrën specifike të OSHCve dhe paraqet kërkesa të ndryshme raportimi për OSHCtë bazuar në buxhetin e tyre vjetor.

Referuar **qëndrueshmërisë dhe lehtësirave financiare,** fondet publike në dispozicion konsiderohen të pamjaftueshme për veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e OSHCve. Transparenca, përgjegjshmëria dhe procedurat e aplikimit dhe përzgjedhjes për shpërndarjen e fondeve publike nga institucionet publike, përfshi edhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), mbeten për t'u përmirësur, në mënyrë që këto fonde t'u përgjigjen sa më mirë nevojave të OSHCve. Kuadri dhe trajtimi fiskal i OSHCve, megjithë disa qartësi që solli ligji i ri për TVSHnë, i cili hyri në fuqi në fillim të vitit 2015, sa i përket përjashtimit nga TVSH dhe veprimtarisë ekonomike të OJFve, paraqet sërish barriera për veprimtarinë efektive të OSHCve. Dy sfida kryesore që pengojnë qëndrueshmërinë financiare të OSHCve mbeten (i) mungesa e rimbursimit të TVSHsë për aktivitetet në kuadër të zbatimit të projekteve IPA dhe (ii) kërkesa nga disa donatorë për të lëshuar fatura me TVSH për grantet. Dhurimet individuale dhe të korporatave nuk mbështeten, promovohen apo nxiten nga shteti dhe si rezultat ato konsiderohen të pamjaftueshme për veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë financiare të OSHCve.

Viti 2015 shënoi disa zhvillime pozitive në aspektin ligjor sa i përket **bashkëpunimit Shtet – OSHC** dhe zhvillimit të OSHCve. Në maj, Qeveria e Shqipërisë miratoi Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile, një dokument që përfshin 9 fusha prioritare veprimi për të mundësuar Qeverinë e Shqipërisë të ndërmarrë një proces efikas vendim-marrjeje në respektim të ngritjes së mekanizmave të rinj, ose për të përmirësuar ato ekzistuese për bashkëpunim me shoqërinë civile, në mënyrë që të kontribuojë në promovimin e qeverisjes me pjesëmarrje, hartimin e politikave gjithëpërfshirëve dhe fuqizimin e demokracisë në vend.

Në nëntor, Parlamenti i Shqipërisë aprovoi ligjin "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", një organizëm kolegjial këshillimor që synon të garantojë bashkëpunimin institucional midis shtetit dhe shoqërisë civile në Shqipëri, për një demokraci të konsoliduar, qeverisje të mirë dhe rritje të transparencës përmes përfshirjes më të madhe të shoqërisë civile në këtë proces. Pavarësisht rritjes së numrit të konsultimeve dhe numrit të OSHCve të përfshira në këto procese, ende konsultimet midis institucioneve shtetërore dhe OSHCve karakterizohen nga një mungesë dialogu kuptimplotë dhe në kohë me shoqërinë civile.

Legjislacioni ekzistues në fuqi, i lejon OSHCtë të konkurrojnë për fonde publike për ofrimin e shërbimeve, por mjedisi ligjor dhe praktik për përfshirjen dhe përfitimin e kontratave publike nga OSHCtë nuk është mbështetës, dhe si rezultat shumë pak OSHC përfshihen në ofrimin e shërbimeve publike me fonde nga shteti. Rëndësia për një përfshirje më të madhe të OSHCve në ofrimin e shërbimeve publike, përmes një mekanizmi të veçantë kontraktues, është reflektuar në dy projekt-ligje të përgatitura nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në 2015: projekt-ligje për Ndërmarrjet Sociale dhe projekt-ligje për Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë.

## Gjetjet Kryesore

Gjetjet Kryesore nga Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile adresojnë gjetjet më të rëndësishme, bazuar në procesin e monitorimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi dhe ndikimit praktik të zbatimit të tyre gjatë vitit 2015.

Në përgjithësi, kuadri ligjor që udhëheq krijimin dhe funksionimin e OSHCve është i rregulluar në shumë prej aspekteve. Megjithatë, regjistrimi i OSHve ende paraqet vështirësi në drejtim të centralizimit të procesit të regjistrimit, kostove të larta financiare, procedurave të gjata dhe mungesës së stafit të specializuar në çështjet ligjore të OSHCve. Standardit Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, merr parasysh natyrën specifike të OSHC-ve në lidhje me pasqyrat financiare dhe format e raportimit.

Fondet dhe niveli i financimit publik nuk kanë pësuar ndryshime domethënëse gjatë vitit 2015. Fondet publike konsiderohen të pamjaftueshme nga OSHC-të për zhvillimin e tyre institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

Ligji për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile janë dy zhvillime të rëndësishme për sektorin, nëpërmjet të cilave shteti ka institucionalizuar njohjen e rëndësisë së zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin. Sfidat qëndrojnë në pjesëmarrjen efektive të OSHCve në proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse. Në nivele të pakonsiderueshme mbetet përftimi i kontratave shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHCtë.

| Nr | 6 gjetjet kryesore të studimit | Referenca Matrica e Monitorimit | Referenca Udhërrëfyesi i BE-së |
|---|---|---|---|
| 1 | Regjistrimi i OSHCve vazhdon të jetë problematik në disa aspekte, si: centralizimi i procesit të regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, kostot e larta financiare, proces i zgjatur dhe mungesa e juristëve, avokatëve dhe gjyqtarëve të specializuar në çështjet ligjore të OSHCve. | Fusha 1<br>Nën-fusha 1.1 | Objektivi Nr. 1<br>Rezultati Nr. 1.1 |
| 2 | Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, i miratuar në 2015, paraqet pasqyra financiare dhe formate raportimi të ndryshme për OSHCtë, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të tyre. | Fusha 1<br>Nën-fusha 1.1 | Objektivi Nr. 2<br>Rezultati Nr. 2.1 |
| 3 | Mungesa e rimbursimit të TVSHsë për veprimet në kuadër të implementimit të projekteve IPA, dhe kërkesat nga disa donatorë për të lëshuar faturën e TVSHsë për grantet vazhdojnë të pengojnë veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë financiare të OSHCve. | Fusha 2<br>Nën-fusha 2.1 | Objektivi Nr. 2<br>Rezultati Nr. 2.3 |
| 4 | Financimi publik është shumë i limituar, i vështirë nga ana proceduriale, dhe nuk kontribuon në zhvillimin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare të OSHCve. | Fusha 2<br>Nën-fusha 2.2 | Objektivi Nr. 2<br>Rezultati Nr. 2.4 |
| 5 | Me miratimin e ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Udhërrëfyesin e Hartimit të Politikës dhe Masave për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile, shteti ka institucionalizuar njohjen e rëndësisë së zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin. Problematike mbetet pjesëmarrja efektive e OSHCve në hartimin e ligjeve dhe politikave. | Fusha 3<br>Nën-fusha 3.1 | Objektivi Nr. 3<br>Rezultati Nr. 3.1 |
| 6 | Mjedisi ligjor dhe praktik për përfshirjen e OSHCve në ofrimin e shërbimeve nuk është mbështetës dhe pak OSHC arrijnë të përfitojnë kontrata nga shteti për ofrimin e shërbimeve publike. Rëndësia për një përfshirje më të madhe të OSHCve në ofrimin e shërbimeve publike, përmes një mekanizmi të veçantë kontraktues, është reflektuar në dy projekt-ligje të përgatitura nga MMSR në 2015: projekt-ligje mbi Ndërmarrjet Sociale dhe projekt-ligje mbi Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë. | Fusha 3<br>Nën-fusha 3.3 | |

## Rekomandimet Kryesore Politike

Rekomandimet kryesore politike janë bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatimin e tyre praktik, dhe adresojnë rekomandimet kryesore politike për krijimin e një mjedisi mundësues për OSHCtë në Shqipëri dhe zhvillimin e shoqërisë civile në përgjithësi.

Një nga rekomandimet kryesore në lidhje me lirinë e organizimit është rishikimi i procedurave të regjistrimit për OSHCtë. Decentralizmi i procesit të regjistrimit dhe rishikimi i procedurave të regjistrimit do ta bënte procesin më të lehtë, më të shkurtër në kohë dhe me pak kosto. Në lidhje me raportimin financiar dhe rregullat e kontabilitetit, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse është konsideruar si një zhvillim pozitiv për OSHCtë. Zbatimi i tij, duke nisur nga viti 2016, duhet të shoqërohet me rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të inspektorëve tatimor mbi ndryshimet në kuadrin ligjor për raportimin financiar dhe rregullat e kontabilitetit të OSHC-ve, si dhe një ndërgjegjësim më i madh i vet OSHCve për këto ndryshime ligjore.

Rritja e nivelit të financimeve publike për OSHCtë, shoqëruar me lehtësim të procedurave dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike që ofrojnë fonde për OSHCtë, përfshi AMSHCnë, do të kontribuonte në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të OSHCve, çka mbetet një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen organizatat.

Mungesa e informacionit zyrtar mbi numrin dhe të dhëna të tjera për OSHCtë, si shpërndarja e tyre gjeografike, madhësia e organizatave, numri i punonjësve, të ardhurat vjetore, burimi i financimit, statusi aktiv dhe pasiv etj., vazhdon

të mbetet problematike. Edhe kur këto të dhëna ekzistojnë (si regjistri i OSHCve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), ato nuk publikohen. Si rezultat, roli dhe vlera e sektorit brenda vendit nuk është e njohur dhe e vlerësuar. Për rrjedhojë, krijimi i një databaze të qëndrueshme të OSHCve që ofron informacion mbi numrin, fushën e aktivitetit, shpërndarjen gjeografike, formën ligjore, numrin e punonjësve, numrin e vullnetarëve, qarkullimin vjetor, burimet e financimit etj., është i nevojshëm dhe duhet të bëhet i disponueshëm për publikun. Informacioni do të kontribuonte në kuptimin e rolit dhe kontributit të OSHCve në zhvillimin e vendit, hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve bazuar në të dhëna të besueshme.

Pjesëmarrja e OSHCve në hartimin e politikave dhe proceset vendimmarrëse është rritur gjatë viteve të fundit. Sidoqoftë, konsultimet me OSHCtë nuk duhet të fokusohen vetëm në nivel informimi, por me pjesëmarrjen e tyre efektive në të gjithë procesin. Për rrjedhojë, një nga rekomandimet kryesore mbetet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të dokumentave strategjikë mbi zhvillimin dhe bashkëpunimin midis shtetit dhe OSHCve, për të siguruar një pjesëmarrje efektive të OSHCve në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes.

Bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHCve në ofrimin e shërbimeve mbetet një fushë për t'u përmirësuar, duke iu referuar gjetjeve të studimit.

| Nr | 6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë | Referenca Matrica e Monitorimit | Referenca Udhërrëfyesi i BE-së |
|---|---|---|---|
| 1 | Rishikimi i procesit dhe procedurave të regjistrimit të OSHCve, që lidhen me autoritetin përgjegjës të regjistrimit, kostot dhe kohëzgjatjen e procesit, pjesë e paketës ligjore për OSHCtë. | Fusha 1<br>Nën-fusha 1.1 | Objektivi Nr. 1<br>Rezultati Nr. 1.1 |
| 2 | Rritja e kapaciteteve dhe përgatitja e manualeve udhëzuese për inspektorët tatimorë mbi ndryshimet në kuadrin ligjor për trajtimin fiskal të OSHCve, përfshi raportimin financiar dhe rregullat e kontabilitetit për OSHCtë. | Fusha 1<br>Nën-fusha 1.1 | Objektivi Nr. 2<br>Rezultati Nr. 2.1 |
| 3 | Rritje e financimit publik për OSHCtë dhe përmirësimi i transparencës dhe procedurave të shpërndarjes së fondeve përmes AMSHCsë dhe institucioneve të tjera që ofrojnë fonde publike për OSHCtë përmes granteve dhe mekanizmave të tjerë. | Fusha 2<br>Nën-fusha 2.2 | Objektivi Nr. 2<br>Rezultati Nr. 2.4 |
| 4 | Krijimi dhe bërja publike e një databaze të qëndrueshme të OSHCve që ofron informacion mbi numrin, fushën e veprimtarisë, shpërndarjen gjeografike, formën ligjore, numrin e punonjësve dhe vullnetarëve, qarkullimin vjetor, burimet e financimit, etj. | Fusha 3<br>Nën-fusha 3.1 | Objektivi Nr. 1<br>Rezultati Nr. 1.2 |
| 5 | Monitorim i vazhdueshëm i zbatimit të dokumentave strategjikë mbi zhvillimin e bashkëpunimit midis shtetit dhe OSHCve, për të siguruar pjesëmarrje efektive të OSHCve në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes. | Fusha 3<br>Nën-fusha 3.2 | Objektivi Nr. 3<br>Rezultati Nr. 3.1 |
| 6 | Rritje e mbështetjes publike për OSHCtë nëpërmjet kontratave publike për ofrimin e shërbimeve, përmes një procedure të veçantë prokurimi, ku përzgjedhja e ofruesit të shërbimeve do të përcaktohet si nga cilësia e shërbimit ashtu edhe nga vlerësimi financiar i kandidatëve. | Fusha 3<br>Nën-fusha 3.3 | |

# Rreth Projektit dhe Matricës

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të "Acquis e Shoqërisë Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve", një projekt i financuar nga BE dhe Balkan Trust for Democracy (BTD), dhe projektit "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave", financuar nga Olof Palme International Center me fonde të Qeverisë Suedeze. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZHSHC) zhvilluar nga BCSDN dhe ECNL. Ajo është pjesë e një serie raportimesh vendore që mbulon 7 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë[1]. Gjithashtu, një Raport Monitorimi rajonal, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve, si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave, janë të disponueshme tek www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha: (1) Garancitë Themelore Juridike të Lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të; (3) Marrëdhënia Qeveri-OSHC. Parimet, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin e zhvillimit dhe diversitetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe në praktikat rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të funksionojë e të zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist i cili të mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimit praktik të tij.

1) Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

# II. Hyrje

## Rreth Raportit të Monitorimit

Si pjesë e nismës "Acquis e Shoqërisë Civile në Ballkan - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHCve", dhe "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave", Partnerët Shqipëri realizoi për të tretin vit rradhazi studimin që rezultoi me Raportin e Matricës të Monitorimit 2015.

Ky raport monitorimi synon të prezantojë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me mjedisin mundësues të OSHCve në Shqipëri si dhe rekomandime se si këto çështje mund të adresohen dhe të zgjidhen.

Raporti i Matricës së Monitorimit 2015, i përgatitur nga Partnerët Shqipëri, bazohet në një hulumtim të legjislacionit shqiptar, politikave, studimeve dhe raporteve të përdorura për të vlerësuar indikatorët ligjorë të Matricës së Monitorimit, si dhe mbi një vëzhgim, intervista të thelluara dhe takime konsultuese me OSHCtë të përdorura për të vlerësuar indikatorët praktikë të Matricës[2].

## Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Acquis e Shoqërisë Ballkanike- Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve" financuar nga BE dhe nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe projektit "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave", financuar nga Olof Palme International Center me fonde të Qeverisë Suedeze. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZHSHC) hartuar nga BCSDN dhe ECNL. Ajo është pjesë e një serie raportimesh vendore që mbulon 7 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë[3]. Gjithashtu, një Raport Monitorimi rajonal, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve, si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave, janë të disponueshme tek www.monitoringmatrix.net.

> Objektivi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i themeleve për monitorimin dhe advokacinë mbi çështjet e lidhura me mjedisin mundësues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë cvile në nivel rajonal dhe vendor si edhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikat e BE dhe procesin e pranimit në nivel Evropian dhe vendor.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm, nga faza e zhvillimit të shoqërisë dhe nga sektori i shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon të përfshijë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues. Më

> Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:
>
> 1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
> 2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
> 3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

2) http://monitoringmatrix.net/wp-content/uploads/2014/04/BCSDN_Monitoring Matrix-tool-kit.pdf
3) Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

tepër ajo thekson ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishme për vendet në të cilat ata kryejnë veprimtarinë e tyre. Megjithatë, standardet janë formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi. Ato janë hartuar nga eksperiencat e OSHC-ve të këtyre vendeve në termat e mjedisit ligjor si edhe praktikës e sfidave në zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standardeve dhe indikatorëve është realizuar duke marrë në konsideratë liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht si edhe praktikat më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat zhvillohen më tej sipas standardeve specifike. Nga ana e tyre, standardet shpjegohen më tej përmes indikatorëve, në mënyrë që t'i japin OSHC-ve lokale, donatorëve apo palëve të tjera të interesuara mundësinë për të parë e monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikat e aplikimit të tij.

Përpunimi i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për ZHSHC-në, ishte pjesë e një përpjekjeje të përbashkët të ekspertëve të OSHC-ve dhe praktikuesve nga rrjeti i anëtarëve e partnerëve të BCSDN dhe me ekspertë e mbështetje strategjike nga ECNL. Skuadra me 11 anëtarë ekspertë përfshiu një mori njohurish e eksperiencash nga OSHC dhe organizata jo-fitimprurëse, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe përfshinte ekspertë nga 10 vende të Ballkanit. Puna me Matricën përfshiu takimet e punës si edhe punën online nga ekspertët, e cila u shqyrtua më tej nëpërmjet fokus-grupeve me aktorë të ndryshëm si edhe konsultimeve publike. Puna mbi përpunimin e Matricës u mbështet nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL brenda Programit të Mjedisit Mundësues Ligjor (LEEP)/Grantit të Inovacionit Ligjor dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

## Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZHSHC) në Shqipëri

Zhvillimi i OSHCve në Shqipëri është ndikuar nga etapat e zhvillimeve përmes së cilave ka kaluar vendi, dhe është shoqëruar me nisma ligjore dhe institucionale që tentojnë të krijojnë një mjedis mundësues për OSHC-të. Numri i OSHCve është rritur me 489 organizata të reja të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës[4] në 2015 (përkatësisht 282 shoqata, 95 qendra dhe 112 fondacione), nga të cilat 368 janë regjistruar dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve[5]. Krahasuar me të dhënat e ofruara në Raportin e Matricës së Monitorimit 2014, numri i OSHCve të regjistruara në 2015, është më i madh se mesatarja e OSHCve (170) të regjistruara çdo vit në periudhën 2005 - 2013[6]. Në një studim të fundit të zhvilluar nga BCSDN, forca e punës brenda sektorit rezulton në një numër prej 7505 punonjësish dhe përfaqëson 0,72% të punësimit total në Shqipëri. Pavarësisht barrierave dhe sfidave me të cilat përballen OSHCtë, të paraqitura më poshtë në raport, madhësia e shoqërisë civile është duke u rritur jo vetëm në numër, por edhe në influencën dhe impaktin në shoqëri, pasqyruar në ndryshime ligjore dhe aktivizëm të OSHCve në vend.

OSHCtë në Shqipëri janë diverse përsa i përket llojit të aktivitetit dhe shërbimeve të ofruara. Ato ofrojnë të mira dhe shërbime në fusha të ndryshme për kategori të ndryshme përfituesish. Siç tregohet në të dhënat e Raporteve të Matricës së Monitorimit për tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015), organizatat që punojnë në fushën e rinisë, kulturës dhe edukimit, dhe shërbimeve sociale përfaqësojnë numrin më të madh të OSHCve aktive. Përveç ofrimit të shërbimeve, disa nga OSHCtë së bashku me OSHC të tjera që punojnë në fushën e demokracisë, janë përfshirë në fushata sensibilizuese, advokuese dhe lobuese drejt influencimit të politikave për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator duke ndikuar në veprimtarinë e OSHCve dhe jetën e përfituesve të tyre.

Përsa i përket shpërndarjes gjeografike, shumica e organizatave janë të vendosura në qytete të mëdha si Tirana, Shkodra, Vlora dhe Elbasani, ndërsa veprimtaria e tyre është shpërndarë edhe në zona të tjera të vendit. Organizatat e vendosura në qytete të vogla dhe zona rurale janë akoma të pazhvilluara dhe nuk kanë staf të qëndrueshëm. Krahasuar me organizatat e vendosura në zona urbane, organizatat të cilat operojnë në zona rurale kanë staf të bazuar në projekte[7].

Të gjitha të dhënat që ofrojnë një panoramë të gjendjes së OSHCve në vend gjenerohen nga studime dhe kërkime të kryera nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, për shkak të mungesës së një baze të dhënash të konsoliduar që do të ofronte

4) Të dhëna të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë, bazuar në kërkesën e PSH.
5) Të dhëna të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në kërkesën e PSH.
6) http://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2014-4/
7) Indeksi i qëndrueshmërisë për Organizatat e Shoqërisë Civile 2014, USAID, fq. 15.

informacion të përshtatshëm, jo vetëm përsa i përket madhësisë së sektorit, por edhe vlerës dhe kontributit që OSHCtë kanë në zhvillimin e vendit. Të dhënat zyrtare statistikore dhe informacioni mbi sektorin, përsa i përket numrit total të organizatave që veprojnë në vend, llojit të tyre dhe veprimtarisë kryesore, shpërndarjes gjeografike, numrit të punonjësve dhe vullnetarëve, të ardhurave vjetore etj. nuk janë të disponueshme dhe nuk publikohen mbi baza të rregullta. Kjo situatë çon në një mungesë të njohjes së rolit dhe vlerës, veçanërisht vlerës ekonomike të sektorit në vend.

Një sfidë kryesore për OSHCtë mbetet stabiliteti financiar i tyre. Sektori vazhdon të jetë financiarisht i varur nga donatorët, dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të OSHCve. Sa i përket mbështetjes financiare nga shteti, ajo vazhdon të mbetet në nivele të ulta për OSHCtë. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është institucioni kryesor publik, i krijuar në 2009, me një mandat për të mbështetur financiarisht OSHCtë. Shuma financiare e shpërndarë nga AMSHC, që nga momenti i krijimit të saj, nuk është rritur në nivele të konsiderueshme vit pas viti. Mbështetja financiare për zhvillimin institucional të OSHCve, si një nga format e mbështetjes që Agjencia duhet të ofrojë për OSHCtë, ende mbetet për t'u zbatur nga Agjencia.

Kuadri ligjor dhe rregullator në vitet e fundit ka qenë subjekt i ndryshimeve dhe amendimeve, duke sjellë një përmirësim të mjedisit mundësues për aktivitetin dhe zhvillimin e shoqërisë civile dhe OSHCve në Shqipëri. Pas miratimit të Rezolutës për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile nga parlamenti në vitin 2014, zhvillime të mëtejshme u bënë në 2015 në kuadër të njohjes së rëndësisë së zhvillimit të OSHCve, me miratimin e ligjit Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues të Shoqërisë Civile. Këto dy dokumenta të rëndësishëm strategjikë ofrojnë një kuadër të përgjithshëm që do të garantojë bashkëpunimin institucional midis shtetit dhe OSHCve dhe vendosin prioritete në mbështetje të krijimit të një mjedisi mundësues për zhvillimin e OSHCve. Zbatimi i duhur i tyre do të ketë një influencë të madhe në përmirësimin e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së OSHCve në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve, krijimin e një dialogu të vazhdueshëm dhe bashkëpunimin e institucioneve publike me qytetarët dhe OSHCtë për të plotësuar objektivat strategjikë në kuadër të integrimit në BE.

Gjatë viteve të fundit, organizatat e shoqërisë civile kanë përshtatur një qasje më të hapur dhe gjithëpërfshirëse në bashkëpunimin e tyre me median dhe përdorimin e medias sociale në zbatimin e aktiviteteve dhe nismave të tyre. Si rezultat, prezenca e OSHCve dhe puna e tyre në publik është rritur. Platformat online të krijuara nga organizatat e shoqërisë civile si: Albanian Crowd[8], Open data[9], Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë[10], etj., kanë kontribuar në rritjen e informacionit, transparencës dhe ofrimin e të dhënave lidhur me shoqërinë civile dhe OSHCtë, që ka ndihmuar nismat dhe veprimet e ndërmarra nga qeveria dhe grupe të tjera interesi në vend. Të gjitha këto iniciativa kanë kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj punës së organizatave të shoqërisë civile, nga 34% në 2014 në 38% në 2015, siç vihet re në Sondazhin e Opinionit Publik: Besimi në Qeveri, i realizuar nga IDM[11]. Në të njëjtin raport, shihet se 35% e qytetarëve besojnë se OSHCtë mund të bëjnë që qeveria të japë llogari ndaj qytetarëve. Megjithatë, të dhënat tregojnë se një transparencë dhe llogaridhënie më e madhe dhe veprime të dukshme nevojiten të ndërmerren nga OSHCtë për të rritur besimin dhe imazhin e tyre në publik.

Në dekadën e fundit (2005-2015) zhvillimi i sektorit ka marrë formë bazuar në zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Ai karakterizohet nga përpjekje për të influencuar vendimmarrjen përmes fushatave lobuese dhe advokuese, për të nxitur përmirësime në kuadrin ligjor dhe rregullator që ndikon OSHCtë dhe mekanizma të tjerë në vend për të krijuar një mjedis mundësues për OSHCtë dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile që operojnë në vend. Nisma për t'u përmendur janë: rishikimi i trajtimit fiskal të OSHCve, rishikimi dhe rregullat detyruese për njoftimin dhe konsultimin publik për projekt-ligjet, strategjitë dhe politikat, krijimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, etj. Për më tepër, si pjesë e situatës politike aktuale në vendet e Ballkanit lidhur me aderimin e tyre në Bashkimin Evropian, OSHCtë në Shqipëri kanë zgjeruar rrjetet e tyre dhe

8) http://www.thealbaniancrowd.org/
9) http://open.data.al/
10) http://www.zgjedhje.al/
11) "Sondazhi i opinionit publik, Besimi në Qeveri 2015", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, fq. 5-6

bashkëpunimin rajonal me organizatat e tjera jashtë vendit, jo vetëm në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, por dhe në nivel Evropian.

BE dhe donatorë të tjerë e kanë vlerësuar shoqërinë civile si një aktor të rëndësishëm në zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, është adoptuar “Udhëzuesi për mbështetjen e BEsë ndaj shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014-2020” dhe në progres Raportin vjetor të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor drejt integrimit në BE, është përfshirë një sesion i veçantë mbi Shoqërinë Civile. Në 2014, Shqipëria ka marrë statusin kandidat për anëtarësimin në BE dhe në kuadrin e vrullit të reformave politike, vëmendja dhe mbështetja e BEsë për të rritur përfshirjen dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe OSHCve në reformat e rëndësishme që qeveria ka ndërmarrë drejt integrimit të vendit në BE, ka qenë e madhe. Bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHCve në procesin e integrimit dhe krijimin e strukturave dhe mekanizmave adekuate për hartimin e politikave publike dhe strategjive është rritur.

## Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri

Që nga lançimi i ciklit monitorues të mjedisit të shoqërisë civile në 2013, Partnerët Shqipëri ka pasur për qëllim një proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës gjatë përgatitjes se Raportit të Matricës së Monitorimit (MM), duke e prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të madh përfaqësuesish të OSHCve në të gjithë vendin. Këtë vit, studimi për përgatitjen e Raportit të MM u realizua në 14 qytete dhe u kontaktuan 200 OSHC për të dhënë kontributin e tyre në Raportin e Matricës së Monitorimit, nga të cilat 102 u përfshinë në studim. Përveç pyetësorit u zhvilluan intervista të thelluara për të kuptuar më shumë në lidhje me situata kontradiktore ose fusha ku mungonte informacioni me qëllim analizimin e të dhënave.

Në po të njëjtën linjë me Raportin e MM 2014, një element i rëndësishëm ishte organizimi i takimeve konsultuese për të paraqitur gjetjet paraprake të Raportit të MM 2015 dhe diskutimi i ndryshimeve ligjore dhe praktike që ndikojnë në veprimtarinë e OSHCve në 2015. Takimet konsultuese u organizuan në 4 qytete (Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Vlorë) me pjesmarrjen e 126 përfaqësuesve të OSHCve. Diskutimet gjatë këtyre takimeve pasuruan gjetjet e raportit monitorues.

Duke marrë parasysh sfidën e mungesës së të dhënave zyrtare publike mbi sektorin (numrin e OSHCve, formën e regjistrimit, shpërndarjen gjeografike, pjesën që zë secila OSHC lidhur me fushën e aktivitetit, etj.) dhe bazuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Partnerët Shqipëri i dërgoi letra zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë informacion lidhur me numrin e OSHCve të regjistruara në këto institucione gjatë vitit 2015. Po kështu iu dërguan letra të gjitha ministrive mbi shumën e fondeve publike që i është dhënë OSHCve gjatë këtij viti dhe Parlamentit të Shqipërisë mbi konsultimin e projekt-ligjeve me OSHCtë, gjatë vitit 2015.

Intensiteti i punës brenda një kohe të kufizuar ishte një sfidë për grupin e vëzhgimit të përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e tyre.

Duke marrë parasysh sfidën në realizimin e intervistave ballë për ballë me drejtuesit e OSHCve në vitet e mëparshme dhe për shkak të kohës së kufizuar për realizimin e studimit, pati një ndryshim të vogël në metodologji lidhur me realizimin e intervistave. Këtë vit, të dhënat u mblodhën përmes një kombinimi intervistash ballë për ballë, me skype dhe me telefon çka e lehtësoi procesin e mbledhjes së të dhënave nëpërmjet intervistave.

## Mirënjohje dhe falënderime

Raporti i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile për Shqipërinë u përgatit në bashkëpunim dhe me mbështetjen bujare të OSHCve, ekspertëve dhe individëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen drejtorëve ekzekutivë të OSHCve, të cilët morën pjesë në këtë studim me një kampion prej 102 OSHC, duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e përkushtuar.

Partnerët Shqipëri falënderon për bashkëpunimin dhe korrektësinë institucionet publike që iu përgjigjën kërkesës me informacionin e kërkuar.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës dhe Olof Palme International Center në Shqipëri për mbështetjen e tyre në zhvillimin, orientimin dhe zbatimin e kësaj përpjekje monitoruese.

# III. Metodologjia

## Përmbledhje e përqasjes metodologjike

Procesi për përgatitjen e Raportit të MM (Matricës së Monitorimit) për vitin 2015 u realizua gjatë periudhës dhjetor 2014 – nëntor 2015. Partnerët Shqipëri përdori një sërë instrumentash metodologjikë, duke përfshirë hulumtim në literaturë, përqasjen me pjesëmarrje në sigurimin e të dhënave dhe informacionit përmes takimeve konsultuese me OSHCtë dhe intervista të thelluara me drejtorët ekzekutivë dhe menaxherët e nivelit të lartë të OSHCve.

Qëllimi ishte monitorimi i legjislacionit dhe indikatorëve të praktikës për të identifikuar progresin ose regresin e mjedisit mundësues duke përfshirë: klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe efektivitetin e zbatimit të tij për veprimtarinë e OSHCve në Shqipëri.

Metodat e përdorura për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit janë si më poshtë:

### Hulumtim literature

Duke marrë parasysh që Matrica e Monitorimit përmban indikatorë rreth legjislacionit dhe praktikës, rishikimi i literaturës u realizua përmes:

*Rishikimit të kuadrit ligjor* – me qëllim monitorimin e kuadrit ligjor dhe rregulloret e hartuara dhe aprovuara për një mjedis mundësues për OSHCtë. Ai përfshiu një rishikim dhe analizë të legjislacionit shqiptar (duke përfshirë vendimet rregulluese), si dhe analiza mbi zbatimin e konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare të miratuara nga Shqipëria;

*Rishikimit të praktikës* bazuar në të dhënat dytësore, si: raporte të vlerësimit të nevojave të OSHCve; raporte të mediave; raporte progresi të përgatitura nga donatorët; nga organizatat ndërkombëtare, nga agjenci kombëtare – me qëllim identifikimin e zbatimit praktik të legjislacionit në vend.

*Kërkesave zyrtare për informacion nga institucionet publike* – Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare publike, Partnerët Shqipëri i dërgoi një kërkesë zyrtare të gjitha ministrive në Shqipëri duke i kërkuar: (i) shumën totale të fondeve të dhëna OSHCve në 2015; (ii) numrin total të organizatave që kanë aplikuar; (iii) numrin total të organizatave që kanë përfituar nga këto fonde; (iv) shumën minimale dhe maksimale të fondeve për një OSHC; (v) numrin e shërbimeve të kontraktuara nga organizatat e shoqërisë civile; (vi) shumën totale të kontratave për shërbimet e prokuruara nga organizatat e shoqërisë civile; (vii) numrin e organizatave të shoqërisë civile, të cilat kanë përfituar nga mbështetja jofinanciare; dhe (viii) llojet e mbështetjes jo-financiare.

Partnerët Shqipëri i dërgoi kërkesë zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve për numrin e organizatave të regjistruara gjatë 2015 dhe Parlamentit të Shqipërisë për numrin e projekt-ligjeve, të cilat janë konsultuar me përfaqësues të OSHCve.

### Vëzhgimi

Vëzhgimi u realizua përmes përdorimit të një pyetësori me 102 OSHC. Pyetësori u plotësua përmes intervistave ballë për ballë, skype dhe telefon me drejtorët ekzekutivë dhe menaxherët e nivelit të lartë të OSHCve gjatë muajit nëntor 2015. Pyetësori u nda në katër sesione kryesore: një sesion për secilën fushë të Matricës së

Monitorimit dhe një sesion për të dhënat demografike të OSHCsë dhe të intervistuarit/ës. Pyetësori kishte një kombinim të pyetjeve të mbyllura dhe me shkallë likert me pyetje të hapura, me qëllim mbledhjen e informacionit mbi perceptimin dhe përvojën e të intervistuarve mbi treguesit e monitoruar. Informacioni i mbledhur nga pyetësorët u përpunua dhe analizua përmes programit SPSS.

Ky vëzhgim u realizua në 14 qytete. Përzgjedhja e kampionit u realizua bazuar në numrin e OSHCve të lokalizuara në secilin qytet, dhe në vullnetin e organizatave për të marrë pjesë në studim. Grafiku 1 paraqet shpërndarjen gjeografike të organizatave pjesëmarrëse në studim.

*Grafiku 1. Shpërndarja Gjeografike e OSHCve të intervistuara*




Përsa i përket formës ligjore të regjistrimit, kampioni është i përbërë nga 55% shoqata, 28% qendra, dhe 17% fondacione, me përqindjet respektive siç tregohet në grafikun 2.

*Grafiku 2. Forma e Regjistrimit të OSHCve të intervistuara*




Kampioni është përfaqësues dhe reflekton universin e OSHCve në vend (74% e gjithë OSHCve të regjistruara deri në vitin 2014 janë *Shoqata*, 12% janë *Qendra* dhe 10% Fondacione)[12]. Tendenca e përzgjedhjes së *Shoqatës* si formë regjistrimi nga shumica e individëve dhe subjekteve që

12) http://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2014-4/

themelojnë një OSHC vërehet edhe në vitin 2015 (57% e OSHCve të regjistruara).

Bazuar në pyetjet me disa alternativa, në grafikun 3 janë paraqitur fushat e punës dhe aktivitetet kryesore të OSHCve të intervistuara. Siç shihet në grafik, ka një dominim të OSHCve që punojnë në fushën e rinisë, kulturës dhe edukimit, ndjekur nga OSHCtë që punojnë në fushën e shërbimeve sociale, ndërsa ka një përfaqësim të ulët nga OSHCtë që punojnë në fushën e biznesit. Pavarësisht ndryshimeve në kampionin e studimit gjatë viteve (2013-2015), ka një qëndrueshmëri të përfaqësimit sipas fushave të aktivitetit të OSHCve të intervistuara, për rrjedhojë mund të dilet në konkluzionin që kampioni është përfaqësues i universit të OSHCve, në një situatë të mungesës së të dhënave zyrtare.

*Grafiku 3. Fushat e aktivitetit të OSHCve të intervistuara*




### Takime Konsultuese

Gjetjet paraprake nga pyetësorët u paraqitën dhe u diskutuan me 126 përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile dhe institucione publike në katër qytete, përkatësisht në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Korçë. Qëllimi ishte konfirmimi i rezultateve nga pyetësorët dhe diskutimi mbi çështjet e tjera problematike në lidhje me mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHCve në Shqipëri, bazuar në eksperiencën e pjesëmarrësve në takimet konsultuese.

## Pjesëmarrja e komunitetit të OSHCve

Partnerët Shqipëri përdori bazën e saj të të dhënave të OSHCve për të informuar dhe ftuar OSHCtë të marrin pjesë në përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2015.

PSH organizoi disa takime konsultuese me OSHCtë që ishin pjesë e kampionit por dhe ato që nuk ishin. Ilustrimi me shembuj të veçantë praktikë ishte shumë i vlefshëm për përgatitjen e raportit të monitorimit. Kjo ofroi një kuadër më të gjerë të situatës së shoqërisë civile që ndihmoi PSH në nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Të gjitha gjetjet mbi treguesit e praktikës janë bazuar në informacionin dhe komentet e dhëna nga OSHCtë që morrën pjesë *në studim mbi zbatimin e kuadrit ligjor.*

### Mësimet e nxjerra

- Pjesëmarrja e komunitetit të OSHCve në përgatitjen e Raportit të MM, provoi edhe këtë vit që përbën një kontribut të vlefshëm për raportin, jo vetëm në ofrimin e të dhënave sasiore për matjen e treguesve praktikë të matricës, por gjithashtu i dha një qasje më praktike dhe cilësore raportit.
- Verifikimi i informacionit nga burime të ndryshme informimi, në rastet e një informacioni të paqartë është vendimtar në prezantimin e saktë të situatës për matjen e treguesve të matricës.

# IV. Gjetje dhe Rekomandime

## Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

### Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

**Standardi 1: Të gjithë individët dhe subjektet ligjore mund të themelojnë, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirisht në organizata të regjistruara apo jo formale, offline dhe online.**

Gjatë vitit 2015 mjedisi ligjor mbi lirinë e organizimit nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve dhe zhvillimeve. Ligji për "Organizatat Jofitimprurëse"[13], ligji "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"[14] dhe Kodi Civil[15] janë ligjet që udhëheqin gjithë ciklin e organizatave në Shqipëri që nga krijimi, veprimitaria, qeverisja deri te mbyllja apo shpërbërja e një organizate.

Në përgjithësi, liria e organizimit është e garantuar nga Kushtetuta dhe kuadri ligjor dhe ushtrohet lirisht nga individët dhe subjektet ligjore, të cilët mund të krijojnë dhe marrin pjesë lirisht në organizata. Këtë liri e ka çdo individ pa diskriminim kombësie, gjinie, moshe, etj. OSHCtë mund të krijojnë lirisht dhe/ose ti bashkohen rrjeteve brenda dhe jashtë vendit dhe mund të përdorin lirisht internetin, median sociale dhe platformat online për të informuar publikun pa ndërhyrje nga ana e shtetit. Veçanërisht në raste emergjence, kjo liri është provuar të jetë shumë e vlefshme për publikun e gjerë dhe përfituesit direkt nga aktiviteti i OSHCve.

Për tu përmendur në 2015 është situata e përmbytjeve në jug të Shqipërisë gjatë muajit shkurt, kur OSHCtë përdorën gjerësisht median sociale për të mobilizuar dhe koordinuar aksionin në mbështetje të familjeve të prekura nga përmbytjet.

Ky vit nuk sjell ndryshime përsa i përket procesit të regjistrimit të OSHCve në lidhje me autoritetin publik përgjegjës për regjistrimin (Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë), procedurat dhe kërkesat për procesin e regjistrimit. Barrierat janë të njëjta për ato OSHC që duan të regjistrohen dhe/ose ri-regjistrohen përsa i përket kostove të shumta financiare, kohore dhe proceduriale.

Procedura e regjistrimit kërkon që OSHCtë të përfaqësohen nga një avokat dhe të noterizohen të gjitha dokumentet e aplikimit, të cilat përbëjnë kosto shtesë për procesin e regjistrimit (kostot variojnë nga 30,000 – 50,000 lekë (220 – 360 €)). Kostot konsiderohen te larta për individët dhe grupet që dëshirojnë të krijojnë një OSHC.

Të gjitha rastet gjyqësore për OSHCtë trajtohen nga sektori tregtar i gjykatës që nuk ka përvojë në këtë fushë, e cila shoqëruar me paqartësinë që ekziston në kuadrin ligjor për regjistrimin e OSHCve krijon hapësira që gjykatësit të bëjnë kërkesa subjektive për regjistrimin e OSHCve. Një shembull tipik është regjistrimi i një fondacioni, ku në praktikë nevojitet një kapital prej rreth

13) Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001, për "Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar
14) Ligji Nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"
15) Ligji Nr. 7850, datë 07/29/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

100,000 lekë (715 €), edhe pse shuma nuk është e përcaktuar në ligj. Së fundmi, ka raste të raportuara kur këto kërkesa janë vendosur edhe për regjistrimin e qendrave. Kundër vendimit të gjyqtarit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës[16].

Rastet e shqyrtimit të aplikimit për regjistrim të OSHCve nuk janë pjesë e kalendarit të gjykatës. Mbetet në zgjedhjen e gjykatësit përkatës të marrë vendimin për datën e seancës sipas volitshmërisë të gjykatësit. Kjo influencon në zgjatjen e procesit të regjistrimit më shumë se 15 ditë (deri në 1 vit), që është afati maksimal i vendosur nga ligji, dhe kjo nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për një mjedis mundësues për OSHCtë.

Të njëjtat vonesa, për të njëjtën arsye janë raportuar për raste ndryshimesh në regjistrin e OJFve, duke krijuar ndërlikime ligjore për OSHCtë. Një shembull ilustrues për këtë është shoqata Youth Act, që kishte nevojë të reflektonte ndryshimin e adresës në regjistrin e gjykatës. Pamundësia për të përmbushur procedurat brenda një muaji, për shkak të vonesave të zhvillimit të seancave gjyqësore, rrezikoi që shoqata të merrte gjobë nga drejtoria e tatimeve (është kërkesë ligjore reflektimi i adresës aktuale në Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm/NIPT).

Një faktor kontribues i kësaj situate është mungesa e juristëve, avokatëve dhe gjykatësve të specializuar për tu marrë me çështjet ligjore të OSHCve që nga përgatitja e dokumentave ligjore, deri te përfaqësimi në gjyq dhe trajtimi i çështjeve gjyqësore të OSHCve.

Përsa i përket shpërbërjes apo mbylljes së një organizate, ligji për "Organizatat Jofitimprurëse"[17] është në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe përshkruan qartësisht termat dhe kushtet e shpërbërjes. Në praktikë, nuk ka raste problematike të identifikuara nga OSHCtë.

Duke marrë parasysh të gjitha çështjet problematike të identifikuara më sipër, ekziston një nevojë për rishikim të procesit dhe procedurave të regjistrimit, pjesë e paketës ligjore për OSHCtë.

### Standardi 2: OSHCtë veprojnë lirisht, pa ndërhyrje të pa justifikuara të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme

Kuadri ligjor garanton të drejtat e OSHCve për të vepruar lirisht dhe në mënyrë të pavarur, duke rregulluar strukturën e tyre të brendshme dhe procedurat e menaxhimit pa ndërhyrje nga shteti. Kjo është konfirmuar nga 85% e OSHCve të marra në shqyrtim, të cilat kanë deklaruar se nuk ka ndërhyrje të shtetit në qeverisjen e brendshme dhe 74% e OSHCve të intervistuara kanë deklaruar se nuk ka praktika mbikqyrëse të tepruara nga ana e shtetit.

*Grafiku 4. Ndërhyrje nga ana e shtetit në procedurat e brendshme të OSHCve të intervistuara*




16) Ligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jo-fitimprurëse", neni 6, pika 2.
17) Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, për "Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, Kapitulli VII, Fletorja Zyrtare 36/2013

*Grafiku 5. Praktika kontrolluese nga ana e shtetit te OSHCtë e intervistuara*




Përsa i përket **rregullave të kontabilitetit dhe raportimit financiar**, në vitin 2015 u miratua Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse[18]. Standardi paraqet konceptet dhe principet kryesore të pasqyrave financiare dhe formatet e raportimit për OSHCtë, duke patur parasysh natyrën specifike të OSHCve. Ky konsiderohet si një zhvillim pozitiv për OSHCtë, që për herë të parë do të kenë rregulla kontabiliteti dhe raportimi financiar të ndryshme nga sektori i biznesit. Një aspekt tjetër pozitiv i këtij Standardi është që ai paraqet kërkesa më të pakta raportimi për organizatat e vogla me të ardhura vjetore më pak se 5 milion lekë (36,000 €). Këtyre organizatave u kërkohet të aplikojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe të ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënimet shpjeguese lidhur me llojin e aktiviteteve apo shërbimeve që ofrojnë. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për OSHCtë do të hyjë në fuqi në janar të 2016, dhe ndikimi i tij do të matet në Raportin e MM të 2016.

Standardi pritet të rrisë efektshmërinë e OSHCve, veçanërisht organizatave të vogla në lidhje me raportimin e saktë dhe në kohë ndaj autoriteteve shtetërore. Midis OSHCve të intervistuara, 19% kanë qenë subjekt i një gjobe nga Drejtoria e Tatimeve për shkak të vonesave apo mungesës së deklarimeve, dhe gjobat nuk janë proporcionale me madhësinë dhe xhiron vjetore të OSHCve.

Në lidhje me pastrimin e parave, pas miratimit të udhëzimit nr. 22, më datë 19/11/2014 për "Mbikqyrjen e OSHCve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në mbështetje të ndalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", nuk u deklarua asnjë rast apo praktikë abuzuese prej inspektorëve tatimorë nga OSHCtë e intervistuara.

### Standardi 3: OSHCtë mund të kërkojnë dhe të sigurojnë lirisht të ardhura financiare nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetet e tyre

Kuadri ligjor aktual nuk paraqet barriera ndaj OSHCve për të kërkuar dhe siguruar lirisht të ardhura financiare nga burime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre, përfshirë grantet, aktivitetin ekonomik dhe donacionet nga korporatat dhe individët[19].

Legjislacioni i lejon OSHCtë të përfshihen në aktivitete ekonomike, me kushtin që aktiviteti të jetë në përputhje me qëllimin e organizatës, dhe në praktikë 39% e OSHCve të intervistuara raportuan se ushtrojnë aktivitet ekonomik. Në përgjithësi, kuadri ligjor (ligjet, vendimet, rregulloret etj.) nuk imponojnë vështirësi administrative për OSHCtë që të përfshihen në aktivitete ekonomike, por ka akoma disa çështje që duhen marrë në konsideratë për të lehtësuar angazhimin e OSHCve në aktivitete ekonomike, si: paqartësitë në praktikat administrative të deklarimeve, tatimi mbi aktivitetin ekonomik dhe mungesa e një ligji të veçantë mbi biznesin social/ndërmarrjet sociale,

18) Udhëzimi nr. 62, datë 17.09.2015 "Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij", nxjerrë nga Ministria e Financave
19) Ligji nr.8788, datë 7 Maj 2001, Mbi Organizatat Jofitimprurëse, i ndryshuar, Neni 35, Fletorja Zyrtare 36/2013

të cilat përbëjnë një ngarkesë për OSHCtë.

Në praktikë, 31% e OSHCve vlerësojnë se kanë vështirësi të kërkojnë dhe të sigurojnë lirisht fonde nga donatorë vendas dhe të huaj në mbështetje të aktivitetit të tyre, 25% e konsiderojnë se është disi e vështirë, dhe 27% e vlerësojnë si të lehtë kërkimin dhe sigurimin e fondeve si nga donatorë vendas ashtu dhe të huaj. Organizatat që e kanë më të vështirë kërkimin dhe sigurimin e fondeve nga donatorët janë kryesisht organizatat e reja që nuk kanë kapacitete në përgatitjen e projekt-propozimeve, nuk kanë informacion mbi partnerët potencialë, rrjetet dhe mundësitë e gjetjes së fondeve. Ato janë gjithashtu organizata të lokalizuara në qytete të vogla, si Kuçovë, Gjirokastër, Lushnjë, Pogradec dhe Pukë, ndërsa organizatat nga Tirana e konsiderojnë më të lehtë kërkimin dhe sigurimin e fondeve nga donatorë vendas edhe të huaj.

Edhe pse nuk ka barriera ligjore të imponuara ndaj OSHCve për të marrë dhe siguruar fonde nga individët, korporatat dhe burimet e tjera, procedurat për marrjen e fondeve nga këto burime janë konsideruar të vështira dhe disi të vështira nga 84% e OSHCve të intervistuara, siç shihet në grafikun 6 më poshtë.

*Grafiku 6. Burimet e të ardhurave në vitin 2015 të OSHCve të intervistuara*




Nën - Fusha 1.1., reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BEsë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020[20].

1.1.a. **Vlerësimi cilësor i legjislacionit ekzistues dhe kuadrit të politikave**

- Janë identifikuar problematikat kryesore në legjislacionin vendas dhe kuadrin e politikave në lidhje me regjistrimin e OSHCve (ligji mbi Organizatat Jofitimprurëse dhe Ligji për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse ).

- Proceset e regjistrimit dhe/ose ri-regjistrimit shkojnë më shumë se 15 ditë (deri në një vit) që është periudha maksimale e vendosur nga ligji siç raportohet nga OSHCtë.

- Kërkesat ligjore për përfaqësim nga një avokat dhe noterizimi i të gjitha dokumentave të aplikimit, rrit kostot e procesit (kosto varion nga 30,000 – 50,000 lekë). Kostot konsiderohen të larta nga individët dhe grupet që duan të krijojnë një OSHC, çka çon në demotivimin e tyre që në nisje.

20) http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/civil_society/doc_guidelines_cs_support.pdf

**1.1.b. Progresi në lidhje me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës**

- Nuk ka progres në përshtatjen dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në lidhje me regjistrimin, mbylljen dhe shpërbërjen e një OSHCje. Çështjet problematike në lidhje me regjistrimin e OSHCve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës vazhdojnë të sjellin kosto shtesë financiare dhe në kohë për procesin.

**1.1.c. Cilësia e mjedisit mundësues për organizatat me bazë komunitare (grass-roots organisations)**

- Organizatat me bazë komunitare (grass – roots organizations) ndikohen njësoj nga problematikat dhe përmirësimet e kuadrit ligjor të mjedisit mundësues për OSHCtë.

**2.1.a. Perceptimi i OSHCve mbi lehtësinë dhe efektivitetin e rregullave financiare dhe kërkesave të raportimit (të ndara sipas llojit/madhësisë së OSHCve)**

- Gjatë vitit 2015 një numër i konsiderueshën i OSHCve të intervistuara kanë qenë objekt i gjobave për çështje të ndryshme që lidhen me raportimin financiar si: vonesat në raportim, vështirësi me sistemin online të raportimit dhe rregulla të paqarta të raportimit financiar. Për rrjedhojë, perceptimi i OSHCve është që rregullat financiare dhe kërkesat e raportimit financiar të aplikuara gjatë vitit 2015 nuk janë efektive për OJFtë.

**2.1.b. Vlerësimi cilësor i rregullave financiare (me fokus në mekanizmat ekzistues ku rregullat financiare dhe detyrimet ndryshojnë sipas ndryshimit të qarkullimit vjetor dhe aktiviteteve jo tregtare)**

- Një zhvillim pozitiv është miratimi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, i cili merr në konsideratë natyrën specifike të OSHCve për përgatitjen e deklaratave financiare dhe formave të raportimit. Kërkesa më të lehta raportimi parashikohen për organizata me të ardhura vjetore nën 5 milion lekë.

## Nën-fusha 1.2. Liritë e tjera

### Standardi 1: Përfaqësuesit e OSHCve, individualisht ose përmes organizatave të tyre gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore

Liria e organizimit paqësor, në të dyja aspektet si në atë ligjor dhe në atë praktik, nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve gjatë vitit 2015. Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën e çdo individi për t'u organizuar lirisht dhe për të shijuar organizimet paqësore si një e drejtë themelore e njeriut, e bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë[21] dhe në ligjin "Për tubimet"[22]. Kjo përforcohet dhe në praktikë sepse 91% e OSHCve të intervistuara shprehen se gëzojnë lirinë e tubimit paqësor dhe 84% e tyre deklaruan se nuk ka përdorim force të ushtruar nga organet e ligjit. Nuk nevojitet leje për të organizuar një tubim, vetëm një njoftim paraprak duhet t'i paraqitet shefit të komisariatit të policisë, jo më vonë se tre ditë para datës së tubimit[23].

### Standardi 2: Përfaqësuesit e OSHCve, individualisht ose përmes organizatave të tyre gëzojnë të drejtën e shprehjes

Liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese[24]. Siç citohet në Raportin e Freedom House për 2015 "Liria e shprehjes është e garantuar me ligj dhe mund të ushtrohet lirisht në vend". Nga vëzhgimi dhe konsultimet me OSHCtë nuk ka raste dhunimi të lirisë së shprehjes. Shpifja rregullohet nëpërmjet kodit penal dhe është e ndëshkueshme me gjoba.

21) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 47
22) Ligji nr.8773, datë 23.4.2001 "Për tubimet"
23) Ibid, Neni 5
24) Ibid, Neni 22

**Standardi 3: Përfaqësuesit e shoqërisë civile, individualisht dhe përmes organizatave të tyre, kanë të drejtën për të marrë dhe ndarë informacion të sigurtë përmes çdo media**

Kuadri ligjor nuk imponon kufizim rreth përdorimit të internetit dhe platformave online. Qeveria nuk kufizon aksesin dhe përdorimin e internetit[25]. Në vitet e fundit, OSHCtë kanë përdorur gjerësisht median sociale dhe krijimin e platformave online me qëllim informimin dhe komunikimin me publikun dhe advokimin për çështjet shqetësuese.

Nën - Fusha 1.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BEsë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

1.1.a. Vlerësimi cilësor i legjislacionit ekzistues dhe kuadrit të politikave

- Kuadri ligjor dhe politikat ekzistuese garantojnë të drejtën e lirisë, shprehjes, tubimit dhe organizimit për të gjithë individët dhe entitetet ligjore. Individët që kërkojnë të bëjnë një tubim paqësor nuk është e nevojshme të marrin leje sipas ligjit (Ligji i Tubimit). Ligji, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kërkon vetëm njoftim paraprak që u paraqitet autoriteteve për të ushtruar lirinë e tubimit.

1.1.b. Progresi në lidhje me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës

- Nuk ka raste dhunimi të këtyre lirive të raportuara nga OSHCtë.

## Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHCtë

### Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OSHCtë dhe donatorët e tyre

**Standardi 1: Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve**

Qëndrueshmëria dhe lehtësirat financiare vazhdojnë të mbeten ndër aspektet më të dobëta për zhvillimin e OSHCve në Shqipëri. Siç tregohet në Grafikun 7, 31% e OSHCve të intervistuara kanë të ardhura vjetore më pak se 10,000 €, ndërsa 37% e OSHCve deklarojnë të ardhura vjetore prej 10,000 – 50,000 €. Vetëm dy organizata kanë raportuar të ardhura vjetore në intervalin e 500,000 – 1,000,000 €: Youth Albanian Professional Services (YAPS) dhe Association for the Social Support of Youth (ARSIS). Burimet e të ardhurave janë të ndryshme për këto dy organizata. YAPS i siguron shumicën e të ardhurave të tij vjetore nga shërbimet me pagesë (75%) dhe një përqindje të konsiderueshme nga prokurimet publike (25%), ndërsa ARSIS i siguron pothuajse të gjitha fondet e saj nga grantet e donatorëve të huaj (90%).

25) Freedom in the World 2015

*Grafiku 7. Të ardhurat vjetore të OSHCve të intervistuara në vitin 2015*




Sektori vazhdon të jetë financiarisht i varur nga donacionet. Burimi kryesor i financimit vjen nga donatorë të huaj siç është raportuar nga 53% e OSHCve të intervistuara. Shumica prej tyre (82%) nuk mbështeten në dhurimet individuale dhe/ose të korporatave, si baza e financimeve të tyre. Këto të dhëna janë bazuar në Raportin e Monitorimin të Aktivitetit Filantropik në Shqipëri i realizuar periodikisht nga Partnerët Shqipëri. Raporti 2015[26] tregon se OSHCtë përfitojnë vetëm 1% nga dhurimet individuale dhe të korporatave.

Financimi publik është konsideruar i pamja-ftueshëm nga OSHCtë e intervistuara dhe vetëm 1% e konsideron si të mundshëm aksesin në këtë financim. Gjithashtu, prokurimi publik paraqet një burim të kufizuar të të ardhurave për OSHCtë. Konstatime të tilla konfirmojnë edhe një herë situatën problematike (si në dy raportet e mëparshme të MM) lidhur me aksesin në fondet publike si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qëndror. Siç përshkruhet më sipër, nga aspekti juridik, nuk ka kufizime të vendosura për OSHCtë në vitin 2015 për t'u angazhuar në aktivitete ekonomike, ndërsa në praktikë vetëm 7% e OSHCve të intervistuara sigurojnë "shumë" ose "mjaftueshëm" të ardhura nga aktiviteti i tyre ekonomik. Shumica e tyre janë organizata që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Një nga ndryshimet kryesore pozitive në ligjin e ri të TVSHsë, miratuar në vitin 2014 dhe të hyrë në fuqi në janar të vitit 2015, është sqarimi i përjashtimit të granteve nga skema e TVSHsë. Ky sqarim në ligj ka sjellë ndryshime të konsiderueshme në perceptimin e OSHCve në lidhje me aplikimin e TVSHsë mbi grantet nga autoritetet tatimore, e cila është reflektuar në përgjigjet e OSHCve të intervistuara në vitin 2015. Ka një rritje të dukshme të numrit të OSHCve që janë përgjigjur se nuk aplikohet taksë mbi grantet nga 49% në vitin 2014, në 89% në 2015. Ende nevojitet një informacion më i gjerë mbi këtë çështje, pasi ka OSHC që janë të paqarta mbi aplikimin e taksës mbi grantet nga autoritetet tatimore.

26) www.partnersalbania.org/raporti_monitorimit_filantropik_2015

*Grafiku 8. Aplikimi i taksës mbi grantet sipas OSHCve të intervistuara*




Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 953, datë 29.12.2014[27], në mbështetje të zbatimit të ligjit të TVSHsë përcakton kriteret dhe procedurat për përjashtimin e OSHCve nga TVSHja. Në bazë të VKMsë, të gjitha aktivitetet që përfshihen në *"aktivitetet në të mirë dhe interes të publikut"*[28] janë të përjashtuara nga TVSHja. Në mënyrë që OSHCtë të përfitojnë nga përjashtimi i TVSHsë, duhet të përmbushin tre kushte njëkohësisht. Këto kushte janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për përjashtimin e aktivitetit ekonomik nga tatimi, siç përshkruhet në Udhëzuesin për Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile[29], si më poshtë:

1. Organet vendimmarrëse të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhura direkt me aktivitetin e organizatës;
2. Veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë. Duke marrë në konsideratë të ardhurat përkatëse, duhet të kenë epërsi të ardhurat nga veprimtaria joekonomike e organizatës;
3. Furnizimet që kryhen nga organizatat jofitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë sektorin tregtar fitimprurës. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, e kryer prej organizatës për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse, për të cilën është krijuar, të arkëtuara gjatë vitit kalendarik, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës[30].

Organizatat që plotësojnë kushtet e përmendura më lart duhet të bëjnë një kërkesë në Drejtorinë Tatimore Rajonale, ku organizata është regjistruar, duke ndjekur procedurën e përshkruar në VKM (neni 3). Vendimi merret nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga kjo procedurë përjashtohen organizatat jofitimprurëse që kryejnë aktivitet ekonomik të përjashtuar nga ligji i TVSHsë siç janë: shërbimet në shëndetësi, arsim etj.[31], në përputhje

27) VKM nr.953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare 3/2015

28) "Aktivitet në të mirë dhe në interes të publikut "- do të thotë çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon vlerat shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare për individin dhe shoqërinë, mbron jetën e njeriut, shëndetin, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihmë dhe mbështetje në raste të fatkeqësive, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe arsimin në lidhje me të, mbështet dhe zhvillon vlerat kulturore dhe historike, traditat, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, ndihmon në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo aspekt tjetër në të mirë dhe interes të publikut.

29) http://monitoringmatrix.net/m-m-reports-coded/the-toolkit/

30) VKM nr.953, datë 29.12.2014 "'Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare 3/2015, fq.2

31) Ligji nr 92/2014 datë 24.07.2014 Mbi TVSHnë në Republikën e Shqipërisë, Neni 51

me dispozitat ligjore. Efektiviteti i procedurës nuk është provuar ende, pasi nga informacionet e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka asnjë aplikim nga ndonjë organizatë gjatë vitit 2015. Ky informacion shpjegon faktin se pse 68% e OSHC-ve të intervistuara janë përgjigjur se ka "aspak" përfitime tatimore për aktivitetin ekonomik.

Përsa i përket TVSHsë, ka ende dy çështje kryesore problematike në lidhje me OSHCtë, si më poshtë:

- Rimbursimi i TVSHsë mbi veprimtaritë në kuadër të zbatimit të projekteve IPA. Që nga viti 2013, kur ka dalë vendimi i Ministrit të Financave[32], nuk ka asnjë organizatë që ka marrë rimbursimin e TVSHsë nga organet tatimore, ndër ato që kanë aplikuar për të ndjekur procedurën e përcaktuar.
- Kërkesat nga disa donatorë për lëshimin e faturës së TVSHsë për grante. Ndryshimet në ligjin e TVSHsë nuk kanë ndikuar në vendimet e këtyre donatorëve për të kërkuar një faturë TVSHje nga OSHCtë që zbatojnë projekte me fondet e tyre në bazë të një marrëveshje kontraktuale granti.

Një tjetër ndryshim në regjimin fiskal gjatë vitit 2015, i cili ka ndikuar në funksionimin e OSHCve është rritja e tatimit mbi fitimin nga 10% në 15%, e cila është konsideruar si një barrë e shtuar nga OSHCtë e intervistuara. Ndryshimi i papritur ka ndikuar negativisht në punën e OSHCve me projektet në zbatim, pasi ka sjellë rishikimin dhe ndryshimin e kontratave me ekspertë dhe konsulentë, si dhe në buxhetimet e projekteve të reja (PSH. rritja e shumës totale të shpenzimeve).

Bazuar në problematikën e identifikuar me trajtimin fiskal/tatimor të OSHCve, ka disa propozime nga OSHCtë për të përmirësuar situatën dhe për të krijuar më shumë lehtësira për funksionimin e tyre, të tilla si: zbritje e tatimit mbi fitimin; trajtimi i ndryshëm tatimor; trajtimi i ndryshëm nga sektori privat për kostot fikse (ujë, energji, komunikim); mbështetja jo-financiare nga autoritetet lokale; trajtim i ndryshëm fiskal për OSHCtë që ofrojnë shërbime; aplikimi i paralajmërimit para vendosjes së gjobës në rast shkelje të kërkesave ligjore; trajnimi i OSHCve për çështjet fiskale; aplikimi i lehtësirave fiskale për biznesin social; heqja e detyrimit për të deklaruar sigurimet për punonjësit, kur organizata nuk ka aktivitet; reduktimi i taksave lokale; organizimi i tryezave të rrumbullakta ndërsektoriale për të identifikuar mënyra të reja bashkëpunimi; krijimi i një sesioni të veçantë në sistemin fiskal për OSHCtë; rritja e informacionit të inspektorëve tatimor mbi OSHCtë.

Nuk ka ndryshime ligjore dhe praktike në lidhje me investimet pasive dhe dhurimet e kushtëzuara në vitin 2015, dhe për këtë arsye nuk ka trajtim të favorshëm tatimor që mund të aplikohet për OSHCtë dhe donatorët.

### Standardi 2: Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata

Kuadri ligjor që rregullon dhurimet nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2015. Ligji mbi Sponsorizimet[33] është ligji kryesor që rregullon dhurimet në Shqipëri. Ligji përcakton si sponsor "vetëm ato subjekte që kanë tipare tregtare, që janë persona fizik apo juridik, ndërmarrje vendase, të huaja ose të përbashkëta", duke përjashtuar kështu nga përfitimet e këtij ligji individët që dhurojnë. Shuma e sponsorizimit njihet si një shpenzim i zbritshëm nëse është deri në masën 3% e fitimit para tatimit (FPT), ndërkohë që shuma e sponsorizimit për shtëpitë botuese dhe për publikimin e veprave letrare, shkencore dhe enciklopedike, si edhe aktiviteteve kulturore, artistike e sportive, njihet si një shpenzim i zbritshëm nëse është deri në masën 5% e fitimit para tatimit (FPT). Lehtësirat tatimore të përcaktuara në Nenin 5 të ligjit, zbatohen nga autoritetet tatimore bazuar në dokumentat vijuese: kontrata e sponsorizimit dhe vërtetimet për realizimin e sponsorizimit[34]. Nëse shuma e sponsorizimit është mbi përqindjen e përcaktuar nga ligji, ajo nuk njihet nga autoritetet tatimore si një shpenzim i zbritshëm[35]. Kuadri ligjor parashikon qartë mënyrën e përfitimit të lehtësirave tatimore

32) Vendim Nr. 4 datë 22.01.2013 i Ministrisë së Financës "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar
33) Ligji nr.7892, datë 21.12.1994, Mbi Sponsorizimin
34) Ligji nr.7892, datë 21.12.1994, Mbi Sponsorizimin, Neni 6
35) Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 Mbi Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, Neni 21, shkronja j)

nga dhurimi (deri në shumën e përcakuar nga ligji), e cila njihet automatikisht si një shpenzim i zbritshëm në sistemin online të tatimeve, bazuar në raportin e dorëzuar nga subjekti. Në praktikë, bazuar në vëzhgimin e PSH me disa kompani private që kryejnë aktivitet filantropik në vend, vihet re një mungesë e të kuptuarit dhe paqartësi e kuadrit ligjor nga ana e kompanive dhuruese, si pasojë disa prej tyre nuk e kërkojnë zbritjen të taksave për dhurimet e tyre.

Pavarësisht kësaj situate (mungesës së lehtësirave fiskale për individët që dhurojnë dhe mungesës së qartësisë për kuadrin ligjor mbi dhurimet), ka raste të dhurimit në Shqipëri. Kjo gjë reflektohet edhe në Raportin Monitorimit të Aktivitetit Filantropik në Shqipëri 2015. Ka 217 raste dhurimi të identifikuara në vitin 2015 nga individë, sektori privat, OSHCtë, institucionet kombëtare e ndërkombëtare dhe komunitetet fetare, siç tregohet në grafikun e mëposhtëm:

*Grafiku 9. Dhurimet sipas natyrës së dhuruesit*




Dhurimet tek OSHCtë janë në nivele të ulëta (vetëm 1%) dhe arsyet e dhëna nga OSHCtë lidhen me mungesën e kulturës së dhurimit tek bizneset, mungesën e informacionit dhe njohurive të biznesit mbi punën e OSHCve dhe ndonjëherë mungesën e besimit dhe vlerësimit për OSHCtë.

Për të përmirësuar situatën e dhurimeve, siç propozohet edhe nga OSHCtë që morën pjesë në studim dhe siç parashikohet edhe në Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile, është i nevojshëm një ndryshim i kuadrit ligjor mbi sponsorizimet. Kuadri ligjor duhet të parashikojë dhe të jetë më orientues për dhurimet nga sektori privat dhe të përfshijë dhurimet nga individët në skemën e lehtësirave tatimore, si edhe është i nevojshëm miratimi i një ligji mbi filantropinë. Për më tepër, për rritjen e dhurimeve tek OSHCtë, është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit të biznesit dhe promovimi i dhurimeve, si edhe krijimi i një besimi të përbashkët dhe një kulture bashkëpunimi mes sektorit privat dhe OSHCve.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe Plani i Veprimit për 2014-2020[36] janë dokumentat kombëtare që përcaktojnë zbatimin e politikave kombëtare për promovimin e investimit të bizneseve për 2014-2020. Përgjegjshmëria Sociale e Biznesit (PSB) është një pjesë kyçe e strategjisë që do të sigurojë konkurrencë të qëndrueshme për kompanitë në Shqipëri. Në raportin e fundit mbi PSB në Shqipëri[37], disa nga sfidat e Shqipërisë në lidhje me PSB, janë të lidhura me rolin e organizatave në zhvillimin e PSB. Sipas raportit, OSHCtë ende nuk e kanë përcaktuar dhe nuk e konsiderojnë rolin e tyre si një partner konstruktiv për të ndihmuar bizneset

36) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 1.10.2014 "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe të Planit të Veprimit për Periudhën 2014-2020" http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/vkm/per-miratimin-e-strategjise-se-zhvillimit-te-biznesit-dhe-investimeve-dhe-te-planit-te-veprimit-per-periudhen-2014-2020&page=6

37) Yperen, van Michiel & Graaf van der Meine (2015), "CSR in Albanian observations & recommendations", fq. 6.

për t'u përmirësuar. OJFtë lokale/rurale nuk janë të përhapura, media dhe OSHCtë nuk kanë arritur ende të kenë një rol në gazetarinë kritike investigative dhe bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm të interesit dhe Partneriteti Publik-Privat nuk hasen zakonisht në praktikë.

Nën-fusha 2.1, reflekton gjithashtu vlerësimin e të gjithë indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

2.2.a. Cilësia dhe aplikueshmëria e kuadrit ligjor për dhurimet nga individët dhe korporatat

- Dhurimet nga individët dhe korporatat ndaj OSHCve janë shumë të limituara siç e tregon dhe grafiku me lart. Kuadri ligjor nuk është i favorshëm dhe nuk nxit dhurimet individuale. Ato nuk janë subjekt i ligjit "Për Sponsorizimin" dhe kështu ato janë të përjashtuar nga përfitimet e këtij ligji për dhurimet.

- Shuma e dhuruar nga sponsori (përfshin vetëm ato subjekte që kanë cilësinë e tregtarit), njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3% - 5% të fitimit para tatimit (FPT), dhe llogaritet automatikisht nga sistemi online i taksave. Në praktikë ekziston një konfuzion dhe paqartësi midis donatorëve në aplikimin e përfitimeve tatimore nga dhurimet.

2.3.a. Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për aktivitetet operacionale dhe ekonomike të OSHCve

- Nëse të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik i OSHCve janë deri në masën 20% të të gjithë të ardhurave vjetore të OSHCsë, ato nuk tatohen.

- Sistemi i përfitimeve tatimore nuk konsiderohet efektiv për aktivitetin operacional dhe ekonomik të OSHCve. Ndryshimet në ligjin e ri të TVSHsë i hyrë në fuqi në 2015 nuk janë zbatur efektivisht, përsa i përket rimbursimit të TVSHsë në projektet IPA dhe kërkesave të disa donatorëve për lëshimin e faturave me TVSH për grantet.

### Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit

#### Standardi 1: Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHCve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE dhe granteve të tjera

Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare mbi mbështetjen e shtetit për OSHCtë dhe për qëllimin e këtij raporti, Partnerët Shqipëri përgatiti dhe dërgoi një letër zyrtare në të gjitha ministritë duke kërkuar: (i) shumën totale të fondeve të shpërndara në 2015 për OSHCtë; (ii) numrin total të organizatave që kanë aplikuar; (iii) numrin total të organizatave që kanë përfituar nga këto fonde; (iv) shumën minimale dhe maksimale të fondeve të shpërndara; (v) numrin e shërbimeve të tenderuara nga organizatat e shoqërisë civile; (vi) totalin e kontratave të shpërndara për shërbimet e prokuruara nga organizatat e shoqërisë civile; (vii) numrin e organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar ndihmë jo-financiare; dhe (viii) llojin e ndihmës jo-financiare.

Bazuar në përgjigjet e tyre, u vu re se vetëm Ministria e Kulturës ka ofruar fonde në formën e granteve për OSHCtë. Bazuar në nenin 26 të Ligjit "Për Artin dhe Kulturën"[38], Ministria e Kulturës ka të drejtë të japë grante për personat fizikë e juridikë, subjektet juridike vendase e të huaja, që kanë fokus promovimin dhe zhvillimin e artit dhe kulturës në Shqipëri. Programi i granteve organizohet nëpërmjet thirrjeve të hapura dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në këto thirrje. Gjatë vitit 2015, Ministria e Kulturës ka dhënë grante në shumën totale prej 31,588,600 lekë (229,000 €) për organizatat e shoqërisë civile[39]. Numri total i organizatave që kanë aplikuar është 118 OSHC, nga të cilat 47 OSHC janë zgjedhur dhe

38) Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 'Për Artin dhe Kulturën", neni 26.
39) Këto të dhëna bazohen në përgjigjen e Ministrisë së Kulturës me kërkesën që Partnerët Shqipëri i dërgoi në kuadër të këtij raporti.

kanë marrë grante nga ministria. Shuma minimale e përfituar nga një organizatë është 107,000 lekë dhe shuma maksimale është 2,200,000 lekë (775 – 16,000 €).

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mbetet institucioni publik kryesor për mbështetjen e OSHCve. Gjatë vitit 2015 AMSHC ka nxjerrë dy thirrje për propozime për OSHCtë. Thirrja e parë për propozime u shpall në muajin mars 2015[40] dhe e dyta u shpall në muajin qershor 2015[41]. Thirrja e parë adresonte nëntë fushat prioritare bazuar në prioritetet e qeverisë dhe prioritetet që dolën nga takimet konsultative që AMSHCja organizoi me OSHCtë. Thirrja e dytë për propozime adresoi gjashtë fusha prioritare duke ftuar organizatat e reja dhe ato që zbatojnë projekte me donatorë të tjerë bashkëfinancues.

Numri total i OSHCve që kanë aplikuar në dy fazat e propozimeve është 264 OSHC, përkatësisht 185 OSHC kanë aplikuar në thirrjen e parë dhe 79 OSHC në thirrjen e dytë për propozime. Numri total i OSHCve, që u shpallën fitues është 59 OSHC, përkatësisht 41 grante të dhëna në thirrjen e parë dhe 18 në thirrjen e dytë.

Shuma totale e financimeve të shpërndara për OSHCtë gjatë vitit 2015 nga Agjencia është 111,500,000 lekë (përkatësisht 73,500,000 lekë në thirrjen e parë dhe 38,000,000 lekë në thirrjen e dytë për propozime). Financimi minimal është në shumën 500,000 lekë ndërkohë që maksimali është 10,000,000 lekë për organizatë.

Krahasuar me Raportin MM 2014, perceptimi dhe eksperienca e OSHCve pjesëmarresë në studim rreth performancës së AMSHCsë nuk ka ndryshuar. Ato kanë informacion mbi rolin dhe funksionimin e Agjencisë, por deklarojnë se Agjencia nuk mbështet në mënyrë të vazhdueshme organizatat e shoqërisë civile dhe nuk adreson nevojat e sektorit. Shumica e OSHCve në takimet konsultuese u shprehën se investimi strategjik dhe institucional për OSHCtë në Shqipëri, sidomos në zonat rurale mungon, edhe pse kjo mbështetje është një nga llojet e mbështetjes që Agjencia duhet të ofrojë. Shqetësimet kryesore të OSHCve lidhur me AMSHCnë janë:

1. Ka një numër të madh dokumentash të noterizuara që kërkohen në procesin e aplikimit, gjë që e bën aplikimin të kushtueshëm;
2. Mungesë transparence në procesin e përzgjedhjes. Mungesë e përgjigjes së shkruar mbi rezultatet e vlerësimit të projekt-propozimeve dhe mbi arsyet e refuzimit të tyre;
3. Ka probleme me standardet e vlerësimit dhe integritetin e mekanizmit të shpërndarjes së financimit;
4. Mungesë transparence në përdorimin e fondeve të shpërndara.

Gjatë vitit 2015, një tjetër burim publik financimi për OSHCtë ka qenë Fondi i Lotarisë Kombëtare. Në përputhje me Ligjin[42], dhe duke ndjekur Vendimin e Këshillit të Ministrave[43] u krijua Bordi i Çështjeve të Mira. Bordi, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financës dhe përfaqësues të Lotarisë Kombëtare, nxorri thirrjen fillimisht në mars 2015, por e rishpalli thirrjen në qershor 2015. Thirrja ishte e hapur për institucione publike buxhetore ose jobuxhetore, dhe për subjektet jobuxhetore fizike ose juridike. Shuma totale e fondit ishte 22,477,227 lekë (164,000 €) dhe u shpërnda për financime afatshkurtra deri në një vit dhe për financime afatgjata deri në tre vite. Një mangësi e thirrjes, siç u përmend edhe nga disa OSHCtë e intervistuara, ishte mungesa e informacionit rreth fushave prioritare të mbështetjes. Kjo mungesë informacioni çoi në konfuzion dhe vuri në pikëpyetje transparencën e procesit të vlerësimit dhe zgjedhjes së fituesve. Në shtator 2015, Bordi mori vendimin, në të cilin u zgjodhën tre projekte fituese për thirrjen e parë për propozime, mes të cilëve dy ishin institucione publike dhe vetëm një organizatë e shoqërisë civile. Në njoftimin e shpallur nuk kishte informacion lidhur me shumën e financimit për secilin nga projektet fituese.

Situata e përshkruar më sipër tregon për një mbështetje të papërfillshme dhe procedura jo transparente mbi financimet publike për OSHCtë, gjë që mbështetet nga gjetjet e intervistave me OSHCtë. Vetëm 12 nga 102 OSHC të intervistuara

40) http://www.amshc.gov.al/web/thirrje/07/
41) http://www.amshc.gov.al/web/thirrje/08/
42) Ligji nr. 95/2013 Për Miratimin e Marrëveshjes së Liçencës për Lotarinë Kombëtare Ndërmjet Ministrisë së Financës, si autoriteti i autorizuar, dhe shoqërisë "OESTERREICHISCHE LOTTERIEN", GMBH, nëpërmjet "*OLG Project*" SHPK.
43) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 04.03.2015, Fletorja Zyrtare 35/2015, fq. 1603

deklaruan se kanë marrë financime publike në vitin 2015. Shuma e financimit publik të marrë varionte nga 100,000 lekë në 4,000,000 lekë (730 € – 30,000 €). Në përgjithësi, organizatat që kanë përfituar financime publike janë organizata që ofrojnë shërbime sociale dhe organizata që targetojnë zhvillimin dhe fuqizimin e të rinjve.

### Standardi 2: Financimi publik është i paracaktuar dhe jepet në mënyrë transparente

Krahas financimeve publike të limituara për OSHCtë, pjesëmarrja e OSHCve në ciklin e financimit publik konsiderohet jo transparente nga 45% e OSHCve dhe 70% e OSHCve deklaruan se financimi publik nuk është i parashikueshëm dhe as lehtësisht i identifikueshëm. Rregullat dhe procedurat e tenderimit për financimet publike konsiderohen më të aplikueshme për sektorin privat duke përjashtuar OSHCtë nga procesi.

Disa nga sugjerimet/rekomandimet e ofruara nga OSHCtë e intervistuara dhe të konsultuara mbi rritjen dhe përmirësimin e mbështetjes financiare të OSHCve nga shteti janë:

- Lehtësim i procedurës dhe kritereve për aplikim;
- Rishikimi i kritereve të tenderimit për prokurimin publik;
- Krijimi i një fondi për prokurimin social dhe rishikimi i ligjit për prokurimin publik;
- Të dhëna zyrtare nga institucionet publike mbi fushën e punës për secilën organizatë.

### Standardi 3: Ka një sistem të qartë llogaridhënie, monitorimi dhe vlerësimi të financimeve publike

Në lidhje me transparencën dhe procedurat e financimit, në Ligjin[44] dhe Rregulloren e procedurave të financimit të granteve të AMSHC, procedurat e llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit janë qartësisht të përshkruara në detaje, në mbështetje të një procesi transparent në të gjitha hapat e tij. Por në praktikë, 69% e OSHCve të intervistuara u përgjigjën se pjesëmarrja e OSHCve në ciklin e financimit publik është "aspak" dhe "pak" transparente, ndërkohë që vetëm 3% e tyre u përgjigjen që ai është transparent. Gjithashtu, OSHCtë e intervistuara konsiderojnë që procesi i përzgjedhjes dhe vlerësimit duhet të jetë më transparent në të ardhmen dhe më shumë informacion të vihet në dispozicion të publikut dhe OSHCve.

### Standardi 4: Ekziston mbështetja jo-financiare nga shteti

Shqipëria nuk ka një ligj apo rregullore të përshtatshme në fuqi me dispozita të veçanta që të autorizojë autoritetet shtetërore të ofrojnë mbështetje jo-financiare për OSHCtë. Mbështetja jo-financiare për OSHCtë është në nivele të ulëta, sidomos në nivel qëndror. Në nivel qëndror vetëm 1 ministri, përkatësisht Ministria e Kulturës, nga 17 të tilla, ka deklaruar të ketë dhënë mbështetje jo-financiare për OSHCtë. Lloji i ndihmës jo-financiare të ofruar nga ministria ka qenë hapësira fizike e vetë ministrisë e ofruar pa pagesë për OSHCtë si edhe ekspertiza e stafit të ministrisë për shkrimin e projekt-propozimeve bazuar në kërkesat e OSHCve.

AMSHCja ka ofruar mbështetje jo-financiare për OSHCtë, përmes organizimit të një sërë eventesh, takimesh dhe tavolinave të rrumbullakta me OSHCtë në nivel kombëtar për çështje të ndryshme të interesit të përbashkët, ku pjesëmarrja e OSHCve të interesuara ka qenë më tepër se 300 OSHC nga i gjithë vendi. AMSHC ka ofruar gjithashtu trajnime mbi thirrjet e saj për propozime dhe për një raportim narrativ e financiar të suksesshëm nga ana e OSHCve.

Në nivel lokal, OSHCtë e vëzhguara deklaruan se nuk tregohet gadishmëri në disa bashki si ajo e Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, dhe Tiranës për të mbështetur OSHCtë me ofrim hapësirash pa pagesë në mënyrë që OSHCtë të realizojnë aktivitetin e tyre dhe as me ekspertizë gjatë zbatimit të aktiviteteve nga ana e OSHCve.

44) "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", Ligj Nr. 10093, datë 09.03.2009

Nën-fusha 2.2., reflekton gjithashtu vlerësimet e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

2.4.a. Rritja e financimit publik për OSHCtë

- Financimi publik është i pamjaftueshëm për OSHCtë dhe vetëm 1% e OSHCve të vëzhguara e konsiderojnë si të mundshëm aksesin në financimin publik. I vetmi organ publik me mandat të qartë për të ofruar fonde publike në mbështetje të OSHCve është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, buxheti i së cilës nuk është rritur dukshëm nga vitet e mëparshme. Një burim tjetër i konsiderueshëm financimi publik për OSHCtë mbetet Ministria e Kulturës që ka dhënë grante me një shumë prej 31,588,600 lekë për organizatat e shoqërisë civile në vitin 2015.

2.4.b. Cilësia e kuadrit të financimit publik për organizatat e shoqërisë civile (e fokusuar në dokumentat procedurial)

- Perceptimi i OSHCve është që cikli i financimit publik nuk është transparent dhe që financimi publik nuk është i parashikueshëm dhe as lehtësisht i identifikueshëm. Rregullat dhe procedurat e tenderave për financimin publik janë konsideruar më të përshtatshme për sektorin privat, duke i përjashtuar OSHCtë nga procesi. Procedurat e AMSHCsë për shpërndarjen e fondeve ndaj OSHCve janë konsideruar gjithashtu jo transparente dhe të ngarkuara përsa i përket dokumentave të kërkuara dhe kërkesave administrative.

## Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore

### Standardi 1: OSHCtë trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë

Kodi i Punës dhe gjithë legjislacioni përkatës i trajton të gjithë punonjësit në mënyrë të barabartë, duke përfshirë edhe të punësuarit nga organizatat e shoqërisë civile. OSHCtë janë subjekt i kërkesave dhe detyrimeve të njëjta si edhe kompanitë fitimprurëse përsa i përket punësimit. Krahasuar me Raportin MM 2014, numri i OSHCve të vëzhguara që deklarojnë se politikat e punësimit nuk janë stimuluese për OSHCtë është rritur me 18%, nga 45% në 2014 ka shkuar në 63% në 2015.

E njëjta çështje problematike si edhe vitet e kaluara mbetet përgjegjësia ligjore që i imponohet OSHCve për të paguar sigurimet për të paktën një punonjës edhe në periudhat kur OSHCja nuk ka fonde dhe aktivitete. Kjo kërkesë rëndon kryesisht organizatat e krijuara rishtazi dhe OSHCtë e vogla që nuk kanë mënyra financiare për të mbuluar këtë pagesë pa patur projekte.

Në një raport të fundit të kryer nga BCSDN, numri total i punonjëse që punojnë në sektor në Shqipëri është 7505 dhe përfaqëson 0.72% të punonjësve në skemën totale të punësimit[45]. Bazuar në gjetjet e studimit të realizuar nga PSH, siç tregohet edhe në grafikun 10, shumica e organizatave që morën pjesë në vëzhgim kanë 0-5 punonjës me kohë të plotë ose/dhe të pjesshme (76% e OSHCve të vëzhguara kanë 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe 86% e OSHCve të vëzhguara kanë 0-5 punonjës me kohë të pjesshme). Intervali tjetër me numrin më të lartë për OSHCtë e vëzhguara është 6-10 punonjës. Ka vetëm dy organizata që kanë më tepër se 30 punonjës me kohë të plotë: ARSIS i cili ofron shërbime komunitare për të rinjtë me 33 punonjës, dhe Youth Albanian Professional Services (YAPS). YAPS ka 14 vite eksperiencë si një organizatë me rol të konsoliduar në treg e cila punon në fushën e shërbimeve sociale, ofron shërbime me pagesë për grupet e targetuara të saj dhe operon gjithashtu si një ndërmarrje sociale me 120 punonjës me kohë të plotë.

45) "Economic Value of the Non-Profit Sector in the Countries of the Western Balkans & Turkey", BCSDN 2015, fq.12.

*Grafiku 10. Punonjës me kohë të plotë në OSHCtë e intervistuara*




*Grafiku 11. Punonjës me kohë të pjesshme në OSHCtë e intervistuara*




### Standardi 2: Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin

Pas disa diskutimeve mbi një ligj të veçantë për vullnetarizmin, projekt-ligji mbi vullnetarizmin u përgatit dhe u dërgua në parlament në 21 tetor 2015 dhe aktualisht është duke u diskutuar në komisionet parlamentare. Synimi i ligjit mbi vullnetarizmin është të rregullojë punën vullnetare dhe të rrisë pjesëmarrjen qytetare në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe promovimin e vlerave të solidaritetit mes njerëzve.

Mungesa e programeve shtetërore mbi vullnetarizmin dhe iniciativave për mbështetjen e vullnetarizmit, reflektohet në numrin e vullnetarëve të përfshirë në OSHC. Siç edhe mund të vihet re në grafikun nr. 12 më poshtë, shumica e organizatave (62%) kanë 0-10 vullnetarë. Janë vetëm 4 organizata që kanë më shumë se 100 vullnetarë si: Intelektualët e Rinj, Shpresa (IRSH), Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN), Agjencia Artistike e Spektakleve në Korçë (AAS) dhe Qendra Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim (ACPD). Këto organizata janë krijuar apo përfaqësohen kryesisht nga të rinj. Këto organizata drejtojnë fushata masive, advokojnë dhe mbrojnë të drejtat e të rinjve, grave dhe fëmijëve. Gjithashtu organizata si: Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN), bazohen totalisht tek vullnetarët me synim shkëmbimin e vullnetarëve kudo nëpër botë. Vullnetarët angazhohen në periudha të përkohshme, bazuar në nevojat e organizatës për realizimin e aktiviteteve specifike.

*Grafiku 12. Numri i vullnetarëve në OSHCtë e intervistuara*




**Standardi 3: Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetar**

Në Ligjin shqiptar për arsimin profesional arsimi joformal përkufizohet si "të mësuarit e planifikuar përmes aktiviteteve të organizuara, jo domosdoshmërisht të hartuara si lëndët mësimore, por që përmban përvojë të rëndësishme të të mësuarit". Edukimi jo formal, gjatë vitit të fundit është planifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dy institucionet publike përgjegjëse për të siguruar dhe ofruar edukim jo formal me aktorë të tjerë dhe midis tyre me organizatat e shoqërisë civile. Gjatë vitit 2013 Ministria e Arsimit dhe Shkencës aplikoi programin "Shkollat si Qendra Komunitare", duke synuar ridimensionimin e rolit të shkollës dhe zhvillimin e potencialit të studentëve bazuar në bashkëpunimin shkollë – prindër – komunitet[46]. Programi parashikon partneritet me OSHCtë në shumë fusha të edukimit dhe shërbimit. Në praktikë, OSHCtë janë gjerësisht të përfshira në edukimin jo formal përmes ofrimit të trajnimeve, shërbimeve dhe kurseve profesionale. Për më tepër, OSHCtë mund të ofrojnë edukimin jo formal pa nevojën e një liçence.

Nën Fusha 2.3., reflekton gjithashtu vlerësimet e treguesve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

**1.2.a. Numri i punonjësve në OSHC (me kohë të plotë dhe të pjesshme)**

- Numri total i punonjësve që punojnë brenda sektorit në Shqipëri është 7505 dhe përfaqëson 0.72% të punonjësve në skemën totale të punësimit. Pjesa më e madhe e OSHCve të intervistuara nga PSH ka 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe të pjesshme.

**1.2.b. Numri i vullnetarëve në OSHC në bazë të llojit të OSHC/sektorit**

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e vullnetarëve në OSHC. Pjesa më e madhe e OSHCve të intervistuara nga PSH (62%) kanë 0-10 vullnetarë.

46) http://educity.al/resources/programe/doc2.pdf

1.2.c. Cilësia e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor i punës nuk është as mbështetës dhe as diskriminues për OSHCtë (duke përfshirë politikat e punësimit aktiv). Projekt-ligji mbi vullnetarizmin ka për qëllim të rregullojë punën vullnetare dhe të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe promovimin e vlerave të solidaritetit midis njerëzve. Ky projekt-ligj është përgatitur dhe çuar në parlament në 21 tetor 2015.

## Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC

### Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

Standardi 1: Shteti njeh, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin

Dialogu dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm mes shtetit dhe OSHCve është thelbësor për të forcuar demokracinë brenda vendit dhe duhet të rrënjoset në veprimet e institucioneve shtetërore që mbështesin organizatat e shoqërisë civile. Viti 2015 shënoi disa zhvillime pozitive lidhur me këtë bashkëpunim. Në maj 2015, Këshilli i Ministrave miratoi Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile[47].

Udhërrëfyesi synon të krijojë mundësi për Qeverinë e Shqipërisë të ndërmarrë një proces efiktiv vendimmarrjeje përmes ngritjes së mekanizmave të rinj ose përmirësimit të atyre ekzistuese për bashkëpunim me shoqërinë civile, në mënyrë që të kontribuojë në promovimin e qeverisjes me pjesëmarrje, hartimin e politikave gjithëpërfshirëve dhe fuqizimin e demokracisë në vend. Udhërrëfyesi parashikon nëntë fusha veprimi, të dala nga konsultimet me OSHCtë në të gjithë Shqipërinë që do të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit për bashkëpunim dhe angazhim me shoqërinë civile. Pritet që Udhërrëfyesi të kontribuojë në një bashkëpunim më efiçent mes qeverisë dhe shoqërisë civile, si një kusht i domosdoshëm për qëndrueshmërinë dhe pakthyeshmërinë e reformave të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Nëntë fushat prioritare janë si vijon:

1. Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile
2. Institucionet që mbështetin bashkëpunimin Qeveri-OSHC
3. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e hartimit të politikave
4. Kuadri i financimit publik për programet e OSHCve
5. Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHCve
6. Raportimi / kontabiliteti financiar dhe trajtimi tatimor i OSHCve
7. Mbledhja e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile
8. Zhvillimi i vullnetarizmit
9. Kontributi i OSHCve në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm në vitin 2015 ishte edhe miratimi i ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, një nismë e ndërmarrë nga organizatat të shoqërisë civile në Shqipëri. Pas angazhimit të qeverisë shqiptare në Konferencën Kombëtare “Partnerë Social - Koha për Veprim”, organizuar në dhjetor 2013, dhe punës advokuese të Grupit të Punës për Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile në Shqipëri gjatë dy viteve të fundit, Parlamenti i Shqipërisë miratoi në nëntor 2015 ligjin “Mbi Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”[48]. Ligji është rezultat i një procesi të gjerë konsultimi të realizuar me OSHCtë në të gjithë Shqipërinë. Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është një organ kolegjial këshillimor që synon të garantojë bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile, në dobi të zgjerimit

47) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 27.05.2015 “Për hartimin e Udhërrëfyesit për Politikën dhe Masat për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile”, Fletorja Zyrtare 94/2015.

48) Ligji nr. 193/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”

të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencies në vendimmarrjen publike, nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë process.

Këshilli Kombëtar do të kontribuojë në bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare për krijimin e një mjedisi mbështetës për sektorin e shoqërisë civile dhe për bashkëpunimin ndërsektorial mes institucioneve publike dhe OSHCve, si edhe për një zhvillim të kapitalit social dhe filantropisë. Këshilli do të përbëhet nga 27 anëtarë, nga të cilët 13 përfaqësues nga ministritë, zyra e Kryeministrisë dhe nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 13 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile dhe një përfaqësues nga Këshilli Ekonomik Kombëtar. Në bazë të ligjit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është sekretariati i caktuar për të lehtësuar punën e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është kryetari i Këshillit. Këshilli pritet të krijohet dhe të fillojë funksionimin e tij në fillim të vitit 2016.

### Standardi 2: Shteti njeh, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të

Ndryshimet në nivel legjislativ, politik dhe strategjik, fatkeqësisht nuk janë shoqëruar me zhvillime të dukshme në nivel praktik në vitin 2015. Kështu, 39% e OSHCve të intervistuara deklarojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OSHCve nuk është përmirësuar, 36% deklarojnë se bashkëpunimi është përmirësuar disi dhe vetëm 25% deklarojnë se bashkëpunimi është përmirësuar.

Krahasuar me Raportin MM 2014 ka një ulje të përqindjes së OSHCve që e shohin bashkëpunimin me shtetin si të përmirësuar (nga 43% në vitin 2014, vetëm 25% në vitin 2015). Në përgjithësi, siç tregohet edhe në Sondazhin e opinionit publik: Besimi në Qeveri", realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)[49], ka një ulje të besimit të qytetarëve në shumicën e institucioneve që u targetuan nga sondazhi i opinionit publik. Gjetjet nga sondazhi i opinionit publik tregojnë se ka një ulje prej 3% në nivelin e besimit në qeveri dhe një ulje prej 7% në nivelin e besimit në parlament .

Për më tepër, rreth gjysma e OSHCve të vëzhguara (52%) konsiderojnë se politikat shtetërore nuk reflektojnë një kuptim korrekt dhe të drejtë të kontributit që sektori i OSHCve ofron sipas fushës së aktivitetit. Institucioneve shtetërore u mungon informacioni mbi numrin, diversitetin dhe shpërndarjen gjeografike të sektorit të OSHCve, gjë që vështirëson pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe efektive të OSHCve në hartimin e politikave dhe strategjive.

Nën Fusha 3.1., reflekton gjithashtu vlerësimet e treguesve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

**3.1.b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave në vend për dialog dhe bashkëpunim midis OSHCve dhe institucioneve publike lidhur me: -përfaqësimin e OSHCve në përgjithësi, - përfaqësimin e OSHCve më të vogla/më të dobëta, - prezencën dhe disponueshmërinë e tyre, - perceptimin e qeverisë mbi cilësinë e strukturave dhe mekanizmave**

- Parlamenti i Shqipërisë në nëntor 2015 miratoi ligjin "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është një organizëm konsultues kolegjial që ka për qëllim garantimin e bashkëpunimit midis shtetit dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, me një përfaqësim të barabartë të OSHCve dhe qeverisë.

- 52% e OSHCve të vëzhguara konsiderojnë se politikat shtetërore nuk reflektojnë një kuptim të saktë dhe të drejtë të kontributit që sektori i OSHCve ofron për fushën e tyre të veprimtarisë. Institucionet shtetërore nuk kanë informacion mbi numrin, diversitetin e sektorit dhe shpërndarjen gjeografike të sektorit të OSHCve, të cilat pengojnë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe efektive të OSHCve në hartimin e politikave dhe strategjive.

49) http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Raporti-i-plote_-sondazhi_besimi-ne-qeveri_2015.pdf

### Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikëbërjës dhe vendimmarrjes

#### Standardi 1: Ekzistojnë standarde që mundësojnë përfshirjen e OSHCve në vendimarrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHCve në kohën e duhur

Miratimi i ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe ligji mbi të Drejtën e Informimit ishin dy zhvillime pozitive gjatë 2014 për vendosjen e rregullave të informimit dhe njoftimit e konsultimit, si edhe për vendosjen e mekanizmave të transparencës në institucionet publike. Megjithatë, si edhe në sesionin e mësipërm, përmirësimet ligjore nuk kanë çuar në ndryshime domethënëse në nivel praktik. Megjithë ndryshimet ligjore, gjysma e OSHCve të intervistuara, mendojnë se institucionet publike nuk i ftojnë në mënyrë të qëndrueshme të gjitha OSHCtë e interesuara për të komentuar nismat politike/ligjore që në fazë të hershme, ndërkohë 23% e tyre janë përgjigjur se janë ftuar disi dhe vetëm 6% e OSHCve të vëzhguara janë përgjigjur se janë ftuar shumë nga institucionet publike. Këto të dhëna mbështeten gjithashtu nga komentet e disa OSHCve se ka një numër të limituar të OSHCve që ftohen vazhdimisht dhe OSHCtë jashtë Tiranës ftohen rrallë në proceset konsultuese në nivel kombëtar. Si edhe vitin e kaluar, problem mbetet situata e ofrimit të informacionit të duhur mbi përmbajtjen e draft dokumentave dhe detajeve të konsultimeve në kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur (p.sh. 64% e OSHCve të intervistuara deklarojnë se atyre nuk i ofrohet ky informacion). Mungon kthimi i përgjigjes së shkruar mbi rezultatet e konsultimeve të bëra publike nga institucionet publike (p.sh. 77% e OSHCve shprehen se nuk marrin përgjigje të shkruar) dhe mungon reflektimi i komenteve e sugjerimeve të ofruara në dokumentat finale. Organizimi i konsultimeve publike kërkon njohuri dhe aftësi specifike dhe punonjësit civilë që përfshihen në proceset e hartimit të politikave duhet të ndjekin trajnime specifike si pjesë e zhvillimit të tyre profesional. Gjysma e OSHCve të vëzhguara mendojnë se shumica e punonjësve civilë në detyrë nuk kanë përmbushur programet e nevojshme arsimore/trajnuese për të përfshirë në mënyrë efektive shoqërinë civile në këtë proces, ndërkohë që 40% mendojnë se këta punonjës janë disi të trajnuar. Kështu, bazuar në këto të dhëna, në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet që ka ende nevojë për punë për një zbatim efektiv dhe të suksesshëm të legjislacionit lidhur me vendosjen e strukturave efektive dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për informimin dhe konsultimin me organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, në vijim është një listë e sugjerimeve të OSHCve për rritjen e përfshirjes së tyre në vendimmarrje:

- Krijimi i një databaze të OSHCve, që përfshin kontaktet e tyre dhe fushën e veprimtarisë;
- OSHCtë duhet të jenë më këmbëngulëse në mënyrë që të jenë pjesë e vendimmarrjes;
- Duhet të realizohen më tepër tavolina të rrumbullakëta dhe takime periodike;
- OSHCtë duhet të informohen në kohë;
- Rritje e ndërgjegjësimit të institucioneve publike për një transparencë më të madhe ndaj OSHCve;
- Të krijohen instrumenta ligjore, të cilat vendosin detyrime për institucionet publike mbi pjesëmarrjen e OSHCve në vendimmarrje;
- Vendosja e mekanizmave monitoruese për procesin e pjesëmarrjes;
- Rritje e konsultimeve me OSHCtë për hartimin e politikave.

#### Standardi 2: Të gjitha projekt-ligjet dhe politikat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku në kohën e duhur.

Aksesi publik në interpretimin e projekt-ligjeve dhe politikave nuk konsiderohet i lehtë nga shumica e OSHCve të intervistuara. Kështu, rreth gjysma e tyre (54%) e vlerësojnë aksesin publik në projekt-ligje dhe politika si të vështirë dhe shumë të vështirë dhe 37% e konsiderojnë disi të vështirë. Megjithatë, ka raste të përfshirjes së OSHCve në procesin e konsultimit për projekt-ligje nga ministritë dhe parlamenti, politika e strategji në nivel lokal e qëndror. Disa nga iniciativat e përmendura nga OSHCtë janë si vijon: Ndryshimi i Kodit të Punës; Projekt-Ligji për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile; Projekt-Ligji për Arsimin e Lartë; Reforma e Shërbimit Social; Projekt-Ligji mbi Vullnetarizmin; Projekt-Ligji mbi Ndërmarrjet Sociale; Projekt-Ligji për Vetëqeverisjen Lokale; Projekt-Ligji për Gjuetinë; Projekt-Ligji për Manaxhimin e Integruar të Kimikateve në Republikën e Shqipërisë; Ndryshimi i Ligjit për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit; Strategjia Kombëtare për Manaxhimin e Zonave të Mbrojtura

dhe Turizmit; Strategjia Kombëtare kundër Përdorimit të Alkoolit dhe Drogave; Strategjia Kombëtare e Rinisë; Strategjia Kombëtare për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane; reforma në Drejtësi; Draft Strategjia për Manaxhimin e Zonës së Mbrojtur Sazan – Karaburun; etj.

Vlen për t'u theksuar se aksesi i publikut, përfshirë këtu edhe OSHCtë, dhe konsultimet me të për hartimin e vendimeve qeveritare është pothuajse i pamundur. Kjo është e një rëndësie thelbësore, duke njohur aspektet normative të këtyre vendimeve. Gjithashtu, ata nuk janë subjekt i ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Parlamenti i Shqipërisë e konsideron pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ si shumë të rëndësishëm. Në informacionin e marrë nga Zyra për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile në Parlamentin e Shqipërisë, përmendet se pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin legjislativ të parlamentit ka shërbyer për një përmirësim në cilësinë e legjislacionit të diskutuar dhe miratuar. Pjesëmarrja është vlerësuar e një rëndësie të veçantë në diskutimet e çështjeve që shqetësojnë grupet në nevojë si: personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, minoritetet, etj.

Bazuar në të dhënat e siguruara nga koordinatori për informim pranë parlamentit, gjatë 2015, ka patur 47 seanca dëgjimore të organizuara nga komisionet parlamentare me pjesëmarrjen e 300 përfaqësuesve të OSHCve/grupeve të interesit/ institucioneve. Siç tregohet edhe në Grafikun 13 më poshtë, komisioni i Shëndetit dhe Veprimtarisë Prodhuese si edhe komisioni i Tregtisë dhe Mjedisit janë dy komisione që kanë organizuar më tepër sesione dëgjimore me OSHC/grupe interesi/ institucione, përkatësisht 15 dhe 13 dëgjesa publike, duke u ndjekur nga komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ky i fundit është komisioni i vetëm që ka organizuar 2 tavolina të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e 43 përfaqësuesve nga OSHCtë dhe ka dërguar 10 projekt-ligje për komente. Vlen për t'u theksuar se këto tre komisione janë ato që kanë realizuar numrin më të madh të takimeve në 2015 krahasuar me komisionet e tjera.

*Grafiku 13. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në dëgjesa publike për projekt-ligje*




Në informacionin e marrë nga parlamenti përmendet se pjesëmarrja aktive e palëve të interesuara në procesin legjislativ është rritur dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, ka akoma vend për përmirësime, pasi nëse krahasohet numri total i projekt akteve ligjore (389) të diskutuara dhe miratuara nga Parlamenti i Shqipërisë në vitin 2015, numri i sesioneve dëgjimore të organizuara me përfaqësuesit e OSHCve dhe grupet e interesit është i ulët (vetëm 47).

Përtej numrave, më e rëndësishmja është konsiderata dhe reflektimi i sugjerimeve/ rekomandimeve të dhëna nga OSHCtë dhe grupe të tjera interesi në ligjet e miratuara. Lidhur me këtë, gjetjet nga Sondazhi i Opinionit Publik të kryer nga

IDM, tregojnë se 43% e shqiptarëve të vëzhguar besojnë se informacionet e dhëna nga OSHCtë dhe grupet e interesit nuk meren në konsideratë.

Në mbështetje të një transparence dhe bashkëpunimi më të madh me shoqërinë civile, gjatë 2015, parlamenti është përfshirë në një sërë aktivitetesh si më poshtë:

- Organizimi i takimit të Sekretarëve të Përgjithshëm të Rajonit të Ballkanit Perëndimor, në bashkëpunim me OSBE, me temën "Parlamentet dhe pjesëmarrja e publikut në konsultime dhe vendimmarrje në procesin legjislativ"
- Trajnim mbi "Transparencën parlamentare", me fokus në këmbimin e eksperiencës me parlamentin e Kosovës mbi transparencën parlamentare dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.
- Sesione trajnimi/informimi mbi "Krijimin e urave midis parlamentit dhe shoqërisë civile", në bashkëpunim me OSBE, organizuar në disa qytete.

Një sërë konsultimesh janë realizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) gjatë 2015, nga të cilat gjashtë janë realizuar me OSHCtë për projekt-ligjin "Mbi Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". Konsultime të tjera janë organizuar rreth ndihmës financiare të programit para aderimit në BE, IPA 2015, në bashkëpunim me Delegacionin e BE në Shqipëri, mbi Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, mbi prioritetet e thirrjes për aplikime nr.7 të AMSHC e cila u konsultua me 200 OSHC.

### Standardi 3: Përfaqësuesit e OSHCve janë partnerë të barabartë në diskutime në organet ndërsektoriale dhe zgjidhen përmes kritereve dhe një procesi të mirëpërcaktuar

Pjesëmarrja e OSHCve në organet ndërsektoriale nuk konsiderohet një proces i lehtë nga OSHCtë e intervistuara, duke qenë se 44% e tyre u përgjigjën se është disi e vështirë të marrësh pjesë në organet ndërsektoriale, 28% e vështirë dhe 20% shumë e vështirë, siç tregohet në Grafikun 14 më poshtë:

*Grafiku 14. Vlerësimi i Pjesëmarrjes në organe ndërsektoriale nga OSHCtë e intervistuara*




Përsa i përket transparencës së përzgjedhjes së OSHCve në organet ndërsektoriale, Grafiku 15 tregon se 59% e OSHCve të vëzhguara mendojnë se procedurat e përzgjedhjes për pjesëmarrjen e OSHCve në organet ndërsektoriale nuk janë transparente.

*Grafiku 15. Transparenca në procesin e përzgjedhjes së OSHCve në organet ndërsektoriale*




Disa nga rekomandimet e ofruara nga OSHCtë e intervistara për një pjesëmarrje efektive në organet ndërsektoriale janë si vijon:

- Miratimi i akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator që përcaktojnë kriteret e përzgjedhjes së OSHCve në organet ndërsektoriale;
- Rregulla detyruese për institucionet publike për publikimin e informacionit mbi OSHCtë e zgjedhura në organet ndërsektoriale;
- Rritje e bashkëpunimit dhe e besimit të përbashkët mes institucioneve publike dhe OSHCve;
- Rritje e kapaciteteve të OSHCve dhe nëpunësve publik.

Nën Fusha 3.2., reflekton gjithashtu vlerësimet e treguesve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit 2014 - 2020.

3.1.a. **Përqindja e ligjeve/urdhëresave, strategjive, dhe reformave politike të konsultuara efektivisht me OSHCtë lidhur me: - aksesin e duhur ndaj informacionit; - kohën e mjaftueshme për të komentuar; - përzgjedhjen dhe përfaqësimin/diversitetin e grupeve të punës; - njohjen e kontributit; - shkallën në të cilën informacioni merret në kosideratë; - reagimin /publikimin e rezultateve konsultuese.**

- Aksesi publik në përgatitjen e projekt-ligjeve dhe politikave nuk është konsideruar i lehtë nga shumica e OSHCve të vëzhguara. Perceptimi i OSHCve është që ka një numër të limituar OSHC që ftohen vazhdimisht në proceset konsultuese, dhe OSHCtë jashtë Tiranës ftohen rrallë në proceset konsultuese në nivel kombëtar. Ashtu si në vitet e mëparshme, situata mbetet problematike në lidhje me ofrimin e informacionit të duhur mbi përmbajtjen e draft dokumentave dhe detajeve të konsultimit në kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur, ofrimi i përgjigjes së shkruar mbi rezultatet e bëra publike nga institucionet shtetërore dhe reflektimi i komenteve dhe sugjerimeve të bëra në dokumentat e përfunduara.

- Gjatë 2015, komisionet parlamentare kanë organizuar vetëm 47 sesione dëgjimore me pjesmarrjen e 300 përfaqësuesve të OSHCve/grupeve të interesit/institucioneve, ndërkohë që është diskutuar dhe aprovuar një numër total prej 389 projektesh nga Parlamenti i Shqipërisë.

### Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

**Standardi 1: OSHCtë janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë; & Standardi 2: Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afatgjatë**

Në aspektin ligjor, nuk ka ndryshime që prekin përfshirjen e OSHCve në ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, OSHCtë mund të konkurojnë për kontrata shtetërore për ofrimin e shërbimeve në fushën sociale, edukim, kujdes shëndetësor, etj. Procedurat e tenderimit dhe kontraktimit drejtohen nga Ligji i Prokurimit Publik i cili i vendos OSHCtë në kushte jo favorizuese krahasuar me ofrues të tjerë shërbimesh, si kompanitë private. Konkurrenca me sektorin privat, me të njëjtat kritere, ku kriteri kryesor i vlerësimit të ofertave është çmimi, duke mos marrë parasysh ekspertizën dhe cilësinë e shërbimit, vë OSHCtë në një situatë të disfavorshme, duke rezultuar që një numër i vogël OSHCsh përfitojnë fonde të prokurimit publik.

Këtë vit Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka përgatitur dy projekt-ligje që kanë ndikim në këtë fushë: projekt-ligji mbi Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe projekt-ligji mbi Ndërmarrjet Sociale. Projekt-ligji mbi Shërbimet Sociale ripohon se shërbimet sociale mund të ofrohen nga persona juridikë publik ose jo publik (përfshirë OSHCtë), që kanë një liçencë për atë qëllim në përputhje me standardet e miratuara nga ministria që është përgjegjëse për çështjet sociale. Procedura aktuale për marrjen e liçencës për ofrimin e shërbimeve konsiderohet e lehtë nga 57% e OSHCve të përfshira në ofrimin e shërbimeve sociale. Projekt-ligji paraqet disa risi dhe zhvillime pozitive për kontraktimin e OSHCve në ofrimin e shërbimeve publike, që adresojnë disa nga rekomandimet e dhëna ndër vite nga OSHCtë si: prokurimi i shërbimeve sociale nga Bashkitë (për ofrimin e shërbimeve në nivel lokal) dhe Shërbimet Sociale Shtetërore (për ofrimin e shërbimeve në nivel qëndror), përmes një procedure negocimi, si një përjashtim i veçantë nga legjislacioni i prokurimit publik; vlerësimi i ofertave do të bëhet bazuar në një raport të drejtë mes çmimit dhe cilësisë së shërbimeve, krijimit dhe administrimit të Fondit Social nga Bashkitë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

Qëllimi i projekt-ligjit mbi Ndërmarrjet Sociale është të rregullojë organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale dhe të përcaktojë kushtet dhe kriteret që kanë nevojë të plotësohen nga një subjekt në mënyrë që të përfitojë statusin e ndërmarrjes sociale. Statusi jepet nëpërmjet një vendimi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, bazuar në aplikimin e subjektit të interesuar. Projekt-ligji përcakton se ndërmarrjet sociale janë organizata jofitimprurëse me anëtarësi të cilat, bazuar në Ligjin për Organizatat JoFitimprurëse, janë shoqata. Në Nenin 26 të projekt-ligjit është përcaktuar se shteti mbështet ndërmarrjet sociale përmes kontratave publike dhe në Nenin 27 përcaktohet se autoritetet publike, sidomos ato lokale, mbështesin ndërmarrrjet sociale përmes prokurimit të të mirave e shërbimeve nga këto subjekte dhe kushtet e procedurat për nënshkrimin e kontratave me ndërmarrjet sociale përcaktohen përmes një vendimi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale. Gjatë konsultimit me OSHCtë, u identifikuan disa kundërshtime në lidhje me ligjin dhe më kryesorja ishte forma e limituar ligjore e subjekteve (shoqatave) që janë të ligjëruara për të marrë statusin e ndërmarrjeve sociale.

**Standardi 3: Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHCtë;**

Në praktikë, gjatë 2015, kufizimet e vendosura nga zbatimi i ligjit të Prokurimit Publik, janë reflektuar në përgjigjet e vëzhgimit me OSHCtë. 46% e tyre u përgjigjën se OSHCtë nuk mund të përfitojnë kontrata në konkurim me ofrues të tjerë dhe 27% u përgjigjën se ato munden disi. Si rezultat, ashtu si në vitet e kaluara thuajse të gjitha OSHCtë e vëzhguara (94%) nuk sigurojnë fonde nga prokurimi publik në ofrimin e shërbimeve. Disa nga arsyet e dhëna për këtë situatë janë si vijon:

- OSHCtë nuk kanë eksperiencë dhe kapacitete për të konkuruar për ofrimin e shërbimeve publike përmes procedurave të prokurimit publik;
- Ekspertiza dhe eksperienca e OSHCve nuk njihet nga autoritetet shtetërore;
- Dështimi në përmbushjen e kritereve të prokurimit;

- Mungesa e transparencës në procedurën e tenderimit;
- Zgjedhja preferenciale e OSHCve;
- Ekzistenca e agjencive publike që konkurrojnë me OSHCtë në kontraktimin publik.

Çështje problematike mbetet jo vetëm kontraktimi por edhe niveli i fondeve publike dhe korrektësia në pagesa. Kështu, 73% e OSHCve të vëzhguara mendojnë se niveli i fondeve publike nuk është i nevojshëm për të mbuluar ofrimin e shërbimeve dhe 64% mendojnë se nuk ka korrektësi në pagesë.

Procedurat e kontraktimit konsiderohen disi të vështira nga 55% e OSHCve dhe të vështira nga 31% e OSHCve. Arsyet për këtë vlerësim lidhen më tepër me mungesën e informacionit nga nëpunësit publik dhe mungesën e ekperiencës së OSHCve me këtë lloj kontraktimi. Prandaj, një nga veprimet e propozuara për të lehtësuar kontraktimin e OSHCve nga shteti për ofrimin e shërbimeve publike është rritja e kapaciteteve të OSHCve për procedurat e kontraktimit. Për më tepër, OSHCtë kërkojnë edhe ndryshime ligjore e politike në këtë fushë. Një kërkesë e vazhdueshme e OSHCve është njohja e prokurimit social, i cili përkrah lehtësirave të tjera që do jepte për rritjen e përfshirjes së OSHCve në tenderimet publike për ofrimin e shërbimeve sociale, do t'i jepte prioritet edhe cilësisë së shërbimeve në vend të çmimit të shërbimeve të ofruara.

### Standardi 4: Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve

Autoritetet publike përkatëse që japin fonde publike për OSHCtë për ofrimin e shërbimeve kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll dhe të monitorojnë cilësinë e shërbimeve që ato ofrojnë dhe për shpenzimet lidhur me ofrimin e këtyre shërbimeve. Ato kanë të drejtë të inspektojnë zyrat në të cilat ofrohet shërbimi, në bazë të njoftimit paraprak. Lidhur me këtë, 75% e OSHCve që kanë patur eksperienca me kontraktimin e shërbimeve nga shteti, raportojnë se nuk kanë qenë subjekt i kontrollit të tepruar nga ana e shtetit dhe 47% pohojnë se monitorimi është kryer bazuar në lajmërim paraprak përmes postës ose elektronikisht. Një çështje problematike e monitorimit identifikuar nga përfaqësues të organizatës Ndihmoni Jetën, është mungesa e eksperiencës dhe profesionalizmit të strukturave monitoruese. Ajo pohoi gjithashtu se rezultatet e monitorimit duhet të bëhen publike për të motivuar organizatat që plotësojnë standardet e kërkuara, ndërkohë ato që nuk i plotësojnë këto standarde duhet të gjobiten.

Disa nga eksperiencat e OSHCve që kanë përfituar kontrata për ofrimin e shërbimeve publike janë si vijon:

**YMCA Albania në Shkodër** - e përzgjedhur nga procedura e prokurimit nga bashkia e Malësisë së Madhe në 2014 për krijimin e një ndërmarrje sociale për të rinjtë dhe për rritjen e kapaciteteve të të rinjve në Malësinë e Madhe. Totali i financimit publik të marrë ishte (1,600 €). Procedurat për marrjen e liçencës konsiderohen të vështira, procedurat e kontraktimit vlerësohen si burokratike dhe të vështira, fondi nuk ishte i mjaftueshëm për të mbuluar kostot e shërbimit për të cilin organizata ishte kontraktuar të ofronte dhe pagesa nuk është kryer në kohë.

**Shoqata e mbrojtjes të drejtave të grave dhe fëmijëve në Berat** – e zgjedhur nga bashkia e Beratit në 2014 për të blerë lodra për fëmijët e qendrës. Totali i financimit ishte 200.000 lekë. Procedurat për marrjen e liçencës dhe për kontraktimin u konsideruan të lehta, pagesa ishte kryer në kohë por fondi nuk ishte i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet e shërbimit për të cilin organizata ishte kontraktuar të ofronte.

**YAPS në Tiranë** - e zgjedhur nga procedura e prokurimit organizuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) për të shpërndarë faturat tek konsumatorët e tij. Procedurat e marrjes së liçencës u konsideruan të lehta, procedurat e kontraktimit u konsideruan disi të vështira me disa burokraci, pagesa ishte kryer në kohë dhe financimi ishte i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet e shërbimit për të cilin organizata ishte kontraktuar të ofrojë.

**Partnerë për Fëmijët në Tiranë** – e zgjedhur nga procedura e prokurimit organizuar nga bashkia e Tiranës për të ofruar shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Procedurat e kontraktimit u konsideruan disi të vështira në fillim për shkak të mungesës së eksperiencës së OSHCsë me këto procedura, por me disa trajnime procedurat u bënë më të qarta e më të thjeshta. Procedura e marrjes së liçencës u konsiderua e thjeshtë, pagesa ishte bërë në kohë dhe financimi ishte i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet e shërbimit për të cilin organizata ishte kontraktuar të ofrojë.

# V. Burime të Përdorura dhe Lidhje të Dobishme


### Lista e dokumentave ligjorë dhe strategjikë, raporte dhe analizat e përdorura

1. BCSDN (2015) "Economic Value of the Non-Profit Sector in the Countries of the Western Balkans & Turkey" [Online] http://www.balkancsd.net/economic-value-of-the-non-profit-sector-in-the-western-balkans-and-turkey/63-12-report-on-the-economic-value-of-the-non-profit-sector-in-the-wbt_final/
2. Vendimi Nr. 4 datë 22.01.2013 i Ministrisë së Financës "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 17 datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar [Online] https://www.tatime.gov.al/sq al/Legjislacioni/COUNCIL_DECISIONS/Legjislacioni%20Tatimor/Tatimi%20mbi%20Vleren%20e%20Shtuar/udhezimi%20nr.%206,%20date%2030.01.2015.pdf
3. IDM (2015), "Sondazh i opinionit të publikut, Besimi në qeveri 2015", [Online] http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Opinion-Poll_trust-in-government_2015.pdf
4. FZ (2001), nr. 23, fq. 701 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf
5. FZ (2001), nr. 28, fq. 872 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/28-2001.pdf
6. FZ (2007), no 130, fq. 3631 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/130-2007.pdf
7. FZ (2010) nr. 166, fq. 8595 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2010/PDF-2010/166-2010.pdf
8. FZ (2013) nr. 36, fq. 1466 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/36-2013.pdf
9. FZ (2014) nr. 114, fq. 5083 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/114-2014.pdf
10. FZ (2014) nr. 157, fq. 8045 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/157-2014.pdf
11. FZ (2014) nr. 200, pg 12036 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/200-2014.pdf
12. FZ (2015) nr. 3, fq. 35 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/3-2015.pdf
13. FZ (2015) nr. 34, fq. 1603 [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyr-


55) Directive no. 22 date 17.11.2014

tare/2015/PDF-2015/34-2015.pdf
14. FZ (2015) nr. 94, fq. 4927 (Online) http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/fletore_zyrtare/Udh%206-8-MF TVSH%236%20FZ_94-2015.pdf
15. FZ (2015) nr. 171, fq. 11840 (Online) http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/171-2015.pdf
16. FZ (2015) nr. 200, fq. 13170 (Online) http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/200-2015.pdf
17. USAID (2014), The 2014 CSO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia (Online) https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/EuropeEurasia_FY2014_CSOSI_Report.pdf
18. Yperen, van Michiel & Graaf van der Meine, "CSR in Albanian observations & recommendations for Albania", dhjetor 2014.

## Lidhje të dobishme në internet

Url: http://www.amshc.gov.al/
Url: http://www.delalb.ec.europa.eu/
Url: http://open.data.al/
Url: https://freedomhouse.org/
Url: http://www.kultura.gov.al/
Url: http://monitoringmatrix.net
Url: http://www.thealbaniancrowd.org/
Url: http://www.zgjedhje.al/

# VI. Shtojca 1

MATRICA E MONITORIMIT MBI MJEDISIN MUNDESUES
PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

## PYETËSOR PËR OSHC-TË

BALKAN CIVIL SOCIETY DEVELOPMENT NETWORK

*PYETËSOR PËR STUDIMIN MBI MATRICËN E MONITORIMIT PËR ZHVILLIMIN E SHOQERISË CIVILE*

TETOR, 2015

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER

SWEDEN

# PYETËSOR PËR OSHC-TË

## PYETËSOR PËR STUDIMIN MBI MATRICËN E MONITORIMIT PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i këtij vëzhgimi është të vlerësojë zbatimin në praktikë të ligjeve, politikave dhe rregulloreve, të cilat ndikojnë në angazhimin qytetar dhe mjedisin mundësues për organizatat e shoqërisë civile. Vëzhgimi është pjesë e një nisme rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Të dhënat e mbledhura përmes këtij pyetësori do të shërbejnë për përpilimin e dy raporteve vjetore dhe raporti rajonali cili do t'i prezantohet Komisionit Evropian në Bruksel. Kjo nismë mbështetet nga Olof Palme International Center nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze, dhe Programi i Partneritetit për Organizatat e Shoqërisë Civile i Bashkimit Evropian.

*Të gjitha të dhënat e mbledhura janë konfidenciale. Ato do të përdoren për analizën e të dhënave në grup duke mos iu referuar në asnjë rast institucioneve të vecanta dhe emrave të përvetshëm.*

### 1. TË DHËNA DEMOGRAFIKE

| | |
|---|---|
| **Emri i të intervistuarit** | |
| **Pozicioni i të intervistuarit në organizatë** | |
| **Emri i plotë i organizatës dhe akronimi** | |
| **Lloji i organizatës** | Shoqatë ☐ Fondacion ☐ Qendër ☐ Ndërmarrje Sociale ☐ |
| **Adresa e plotë e organizatës** | |
| **Telefon dhe email** | |

| | |
|---|---|
| **Fusha e veprimtarisë së organizatës**<br><br>**(Ju lutem rrethoni të gjitha opsionet që janë të aplikueshme)** | Biznes ☐ Demokracia ☐<br>Gruaja ☐ Kultura dhe Edukimi ☐<br>Mjedisi ☐ Shërbimet Sociale ☐<br>Rinia ☐ Shëndeti ☐<br>Tjetër ........................................................ |
| **Viti i themelimit** | |
| **Viti i regjistrimit** | |
| **Numri i punonjësve dhe personave të përfshirë në organizatë** | Kohë të plotë ______ Kohë të pjesshme _______<br>Vullnetar ________ Shtazhier _________ |
| **Të ardhurat vjetore të organizatës gjatë vitit të fundit** | ☐ Më pak se 10 000 EUR<br>☐ Nga 10,000 në 50,000 EUR<br>☐ Nga 50,000 në 100,000 EUR<br>☐ Nga 100,000 në 500,000 EUR<br>☐ Nga 500,000 në 1,000,000 EUR<br>☐ Mbi 1,000,000 EUR |

## 2. GARANCITË THEMELORE JURIDIKE TË LIRIVE

**2.1** Si e vlerësoni procesin e krijimit të OSHC (Organizatave të Shoqërisë Civile) nga individë dhe subjekte juridike?

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**2.2** Si e vlerësoni lirinë e pjesëmarrjes së individëve në organizata formale dhe joformale, offline dhe online?

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**2.3** Nëse e vlerësoni si të vështirë, cilat janë arsyet?

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

**2.4** Si e vlerësoni rolin e shtetit në qeverisjen dhe aktivitetin e OSHC?

*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Ka ndërhyrje të shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC | Sanksionet aplikohen në raste të rralla/ ekstreme | Sanksionet janë në proporcion me natyrën e shkeljes | Sanksionet janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor | Ka praktika të mbikqyrjes zaptuese të shtetit të cilat imponojnë kërkesa të rënduara raportimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**2.5** Ju lutem sillni një shembull për ndonjë nga alternativat bazuar në eksperiencën e organizatës suaj.

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

| **2.6 A përfshihet organizata juaj në kryerjen e aktiviteteve ekonomike direkte?** | Po ☐ | Jo ☐ |
|---|---|---|

**2.7** Si e vlerësoni lirinë që kanë OSHC për sigurimin e burimeve financiare nga donatorë vendas dhe të huaj?

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**2.8** Nëse përgjigja juaj është nga 1-3, ju lutem shpjegoni Pse?

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

......................................................................................................................................................................

**2.9** Si i vlerësoni procedurat e sigurimit të fondeve nga individët, koorporatat dhe burime të tjera?

| Shumë të vështira | Të vështira | Disi të vështira | Të lehta | Shumë të lehta |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**2.10** Nëse përgjigja juaj është nga 1-3, ju lutem shpjegoni Pse?

..................................................................................................................

..................................................................................................................

..................................................................................................................

**2.11** Si e vlerësoni lirinë e organizimit paqësor nga OSHC?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Respektohet liria e tubimit | Ka kufizime por arsyet bëhen të ditura me shkrim | Ka përdorim të forcës së ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit. | Ka raste te lirisë se mbledhjes nga OSHC pa autorizim paraprak | Media është e pranishme në këto mbledhje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**2.12** Cili është niveli i lirisë së shprehjes nga OSHC?

..................................................................................................................

..................................................................................................................

..................................................................................................................

**2.13** Cili është vlerësimi juaj rreth bashkëpunimit të OSHC me median?

..................................................................................................................

..................................................................................................................

..................................................................................................................

## 3. KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË

**3.1 A siguroni të ardhura nga burime financimi si më poshtë?**
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Grante nga donatorë të huaj | Grante nga Qeveria Qëndrore | Grante nga Qeveria Lokale | Shërbime të ofruara nga OSHC | Prokurimi Publik | Dhurimet | Puna Vullnetare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**3.2 Bazuar në vitin e kaluar Fiskal (2015), sa % e të ardhurave të organizatës tuaj janë përfituar nga burimet e mëposhtme (ju lutem tregoni përqindjen totale në kllapa) (ju lutem vini re se shuma totale e burimeve të ndryshme financiare nuk duhet të kalojë 100%)?**

- *Grante nga donatorë të huaj* [------ %]
- *Grante nga Qeveria Qëndrore* [------ %]
- *Grante nga Qeveria Lokale* [------ %]
- *Shërbime të ofruara nga OSHC-ja* [------ %]
- *Prokurimi Publik* [------ %]
- *Dhurimet* [------ %]
- *Puna vullnetare* [------ %]
- *Pagesa anëtarësimi* [------ %]
- *Tjetër (Ju lutem shpjegoni):________________________*[------ %]

*TOTAL* [100%]

**3.3 Cili është vlerësimi juaj mbi trajtimin tatimor për burimet e mëposhtme të të ardhurave?**
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Aplikohet taksë direkte ose indirekte mbi grantet | Përfitimet tatimore për aktivitetin ekonomik të OSHC janë efektive dhe mbështësin OSHC | Nuk aplikohen sanksione për investimet pasive të OSHC |
|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ |

| 3.4 A keni përfituar ndonjëherë nga dhurimet e kushtëzuara (endowments) si një burim të ardhurash për organizatën tuaj? | Po ☐ Jo ☐ |
|---|---|

3.5 Nëse përgjigja juaj është "Po", cila është kostoja e dhurimeve që mundëson gjenerimin e të ardhurave?
.....................................................................................................................
.....................................................................................................................
.....................................................................................................................

3.6 Cilat janë përfitimet tatimore që do të kërkonit për mbështetjen e OSHC-ve?
1. .....................................................................................................................
2. .....................................................................................................................
3. .....................................................................................................................

3.7 Si është vlerësimi i financimit publik (nga ana e shtetit) në mbështetje të zhvillimit institucional të OSHC?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Fondet publike u përgjigjen nevojave të OSHC | Ekzistojnë organe shtetërore me mandat të qartë për shpërndarjen/ monitorimin fondeve publike | Financimi është i parashikueshëm, dhe lehtësisht e identifikueshme | Pjesëmarrja e OSHC në ciklin e financimit publik është transparente |
|---|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

3.8 Cila është shuma e financimit publik që organizata juaj ka marrë në periudhën 2015?
_______________

3.9 Sipas vlerësimit tuaj sa stimuluese janë politikat shtetërore për nxitjen e punësimit në sektorin e shoqërisë civile?

| Aspak stimuluese | Disi stimuluese | Neutral | Stimuluese | Shumë stimuluese |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**3.10** A jeni në dijeni të programeve shtetërore që mundësojnë vullnetarizmin?

Po ☐ Jo ☐

**3.11** Nëse përgjigja juaj është po, ju lutem përmendni. ________________________________

**3.12** Cili është vlerësimi juaj mbi programet shtetërore që mundësojnë vullnetarizmin?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | Programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OSHC | Procedurat administrative për organizatorët e aktiviteteve vullnetare nuk janë të komplikuara | Ka raste ankesash mbi kufizime ndaj vullnetarizmit |
|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ |

**3.13** Sa stimulues është sistemi arsimor (arsimi formal dhe joformal) në promovimin e angazhimit qytetar?

| Aspak stimulues | Disi stimulues | Neutral | Stimulues | Shumë stimulues |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

## 4. KUADRI DHE PRAKTIKAT PËR BASHKËPUNIM QEVERI - OSHC

**4.1** Cili është vlerësimi juaj mbi bashkëpunimin Qeveri – OSHC?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | OSHC marrin pjesë në të gjitha fazat e zbatimit të dokumentave strategjikë që kanë të bëjnë me marrëdhënien Shtet - OSHC | Bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHC është përmirësuar | Zbatimi i dokumentave strategjik është monitoruar, vlerësuar dhe rishikuar periodikisht | Politikat shtetërore për bashkëpunimin Shtet – OSHC janë të bazuara në të dhëna të besueshme |
|---|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**4.2** Ju lutem sillni një shembull për ndonjë nga alternativat bazuar në eksperiencën e organizatës tuaj

..............................................................................................................................

..............................................................................................................................

..............................................................................................................................

**4.3** Cili është vlerësimi juaj mbi nivelin e përfshirjes së OSHC në vendimmarrje?

| Shumë i ulët | I ulët | Disi | I lartë | Shumë i lartë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**4.4** Nëse përgjigja juaj është nga 1-3, ju lutem shpjegoni Pse?

..............................................................................................................................

..............................................................................................................................

..............................................................................................................................

**4.5** Si e vlerësoni aksesin nga ana e publikut në projekt - ligje dhe politika

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**4.6** Ju lutem listoni ligjet në të cilat ju keni marrë pjesë aktive gjatë vitit 2015 (e-konsultime, tryeza të rrembullakta, grupe pune, etc.)

1. ..............................................................................................................................
2. ..............................................................................................................................
3. ..............................................................................................................................

**4.7** A ekzistojnë struktura përfaqësuese të OSHC si pjesë e planifikimit ndër-sektorial?

Po ☐ Jo ☐

**4.8** Si e vlerësoni procesin e përfaqësimit të OSHC në strukturat e planifikimit ndër-sektoriale?

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**4.9** Sa të qarta dhe transparente janë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes?

| Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**4.10** Cilat janë tre kriteret që sigurojnë që partneriteti të jetë efektiv?

1. ........................................................................................................................................
2. ........................................................................................................................................
3. ........................................................................................................................................

**4.11** Ciat janë mundësitë e OSHC për të konkurruar për kontrata shtetërore?
*((Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | OSHC janë në gjendje të përfitojnë kontrata në konkurrencë me ofruesit e tjerë | OSHC janë të përfshira në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve | Në rastet kur kërkohet liçenca, procedurat e marrjes së saj janë të lehta. |
|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ |

**4.12** Cili është roli i shtetit në financimin e shërbimeve të ofruar nga OSHC?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | OSHC janë përfituese të fondeve për shërbime | OSHC marrin fonde të mjaftueshme për të mbuluar shërbimet bazë të cilat janë kontraktuar të ofrojnë | Pagesa kryhet në kohë |
|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ |

**4.13** Si i vlerësoni procedurat për kontraktimin e shërbimeve të OSHC?

| Shumë i vështirë | I vështirë | Disi i vështirë | I lehtë | Shumë i lehtë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

**4.14** Listoni tre kushte që do të lehtësonin kontraktimin e shërbimeve të OSHC nga shteti.

1. ..........................................................................................................................................
2. ..........................................................................................................................................
3. ..........................................................................................................................................

**4.15** Si është procesi i monitorimit të strukturave të shtetit ndaj shërbimeve të ofruara nga OSHC?
*(Ju lutem vlerësoni nga 1-5, ku 1 – Aspak; 2 –Pak; 3 Disi; 4 – Mjaftueshëm; 5 – Shumë)*

| | OSHC janë subjekt i kontrollit të tepruar | Monitorimi kryhet bazuar në procedura dhe kritere të paranjoftuara | Rezultatet monitorimit vihet në dispozicion të publikut |
|---|---|---|---|
| 1 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | ☐ | ☐ | ☐ |

**4.16** Ju lutem sillni një shembull për njërën nga alternativat bazuar në eksperiencën tuaj?

..........................................................................................................................................

..........................................................................................................................................

..........................................................................................................................................

**4.17** Listoni tre priorite për krijimin e një mjedisi mbështetës për veprimtarinë e OSHC.

1. ..........................................................................................................................................
2. ..........................................................................................................................................
3. ..........................................................................................................................................

**Faleminderit për kontributin dhe kohën tuaj!**

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint

RAPORTI PËR SHQIPËRINË
2015